

**UNITED
NATIONS**
United Nations Interim
Administration
Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**DËGJIM PUBLIK
I KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË,
TEKNOLOGJI, KULTURË, RINI DHE SPORT**

**Prishtinë,
më 18.4.2007**

Dëgjim publik i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport për Ligjin për kinematografinë e Kosovës

KRYETARI I KOMISIONIT ENVER HOXHAJ – Të nderuar kolegë, të nderuar miq të fushës së filmit. Komisioni Parlamentar për Arsim, Kulturë; dhe Rini organizon këtë dëgjim publik, si mënyrë të shpejtë të reagimit në një shkresë që kemi marrë nga Unioni i Artistëve të Filmit të Kosovës. Pas marrjes së shkresës ku na jem, kuptohet në fund të ligjit, në fund të listës po synoj të jem më funksional në kuptimin e punës që kemi dhe obligimit karshi edhe komunitetit të njerëzve që merren me kulturë edhe të komunitetit të artistëve.

Komisioni ka vendos që ta organizojë një dëgjim publik sa i përket Ligjit për kinematografi, i cili është miratuar në Kuvendin e Kosovës në korrik të vitit 2004. Unë nuk jam i thirrur që të bëj komente mbi letrën, mirëpo ajo se çfarë përmban letra definitivisht neve na ka shty që ta organizojmë këtë dëgjim publik, meqë këtu kemi të bëjmë me tri aspekte të cilat janë shumë kyçe për të cilat është përgjegjësi e punës së Komisionit.

Çështja e parë është e implementimit të ligjit ,do të thotë sa vërtetë ka mund të implementohet ligji në formën se si është paraparë që të implementohet prej faktit të dilemës që na e kemi a ja nxjerrë apo nuk ja nxjerrë akte të ndryshme administrative nënligjore, të cilat do ta mundësonin implementimin e tij.

Si çështje e dytë e cila përmendet në letrën e ardhur nga Unioni i Artistëve të cilën jam shumë i sigurt që ju do ta shtroni me energjinë dhe në formën më profesionale të mirë të mundshme ka të bëjë me mospërfillje, për më tepër edhe me shkelje të ligjit. Ne si institucion që nxjerrim ligje jemi thjeshtë të obliguar të shohim ku shkelet, pse shkelet ligji dhe pse nuk përfilllet ligji, sidomos nga institucionet si Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Kulturës, të cilat e kanë sponzoru një ligj në vitin 2004 dhe

E treta ka të bëjë sidomos jo vetëm në atë aspektin simbolik që ka të bëjë me fushën e kulturës, por edhe me aspektin material ,do të thotë mënyrën se si janë përdor, përdoren buxhetet, sa ndahen buxhetet për këtë fushë të filmit. Një drejtim të tillë ne kemi reaguar në përputhje me kalendarin tonë të punës në formën sa më të shpejtë.

Ky dëgjim publik, si krejt dëgjimet e tjera publike janë të mendume që flasin ata që ftohen në dëgjim publik, por nëse kolegët e mi deputetë janë të interesuar para se përfaqësuesit të komunitetit të artistëve vetë artistët ta thonë atë se çfarë mendojnë për këtë ligj, për shqetësimet e tyre, kuptohet që kanë të drejtën e fjalës, mund ta japin kontributin e tyre. Mirëpo, natyra e dëgjimit publik është ne

të informohemi ,të mbledhim ide dhe t'i njohim problemet dhe shqetësimet të cilat e përcjellin implementimin e ndonjë ligji në fusha të caktuara.

Unë jam i detyruar dhe për shkak të respektimit edhe të protokollit institucional dhe të dinjitetit shtetëror personal] t'ju informoj që ditën e djeshme kam marr një shkrim nga ministri i Kulturës, i cili neve na informon në këtë dëgjim publik që ai nuk do të jetë i pranishëm, meqë më datën 18 dhe 19 prill do të jetë në Strasburg, me një ftesë të Këshillit të Evropës për të marrë pjesë në një inkurajim të një ekspozitës sa i përket trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Këtu është edhe ftesa në gjuhën angleze.Nëse dikush dëshiron ne mund të ju bëjmë një kopje ta shihni që e kemi marrë shkresë të tillë. Mirëpo, në bisedë e sipër me nënkryetarin e Komisionit me prof. Ali Musaj, me disa anëtarë të Komisionit, me një pjesë të artistëve ne kemi vendos që këtë dëgjim publik ta mbajmë ,me qëllim që pas këtij dëgjimi publik ta caktojmë menjëherë një datë tjetër, ta thirrmi edhe një herë ministrin se nëse ministri udhëton definitivisht ne do të jemi në Kosovë. Kështu që me këtë unë në emër Komisionit për Arsim, Kulturë dhe Rini e përmbylli këtë hyrje shumë të shkurtë .Nëse kolegët e mi deputetë janë të interesuar të shtojnë diçka është më se mirëseardhur. Nëse jo kesh vetëm i detyruar t'ju shpjegoj mos praninë e ministrit të Kulturës, që do të thotë ne e kemi ftuar ministrin e Kulturës të jetë këtu i pranishëm, nëse jo atëherë ju jap fjalën juve çka jeni të pranishëm këtu. Për neve si Komision është nderë që gjithë juve ju njohim me emra dhe mbiemra ,por në kuptimin e traditës së Komisionit vazhdimisht kërkojmë që njerëzit të prezantohen me emër dhe me mbiemër. Kështu që unë nuk do të ftoj me emër e mbiemër, por ju kisha lut që secili prej jush ta prezantoni veten, institucionin ose edhe fushën për cilën jeni aktiv.

A do dikush nga Komisioni fjalën? Jo. Nëse jo, fjala është e juaja. Urdhëroni zotëri.

Jam Fahri Hysa, regjisor tash momentalisht në Fakultet të Arteve jap, ligjëroj historinë e filmit. Kam qenë nja katër seanca kur është përpiluar ligji prej z. Agim Sopi dhe një juristi të njohtur dhe disa tjerëve. Pastaj kemi marrë pjesë në dëgjimin e neneve veç e veç, kemi shqyrtuar nen për nen, kemi pas përplasje të jashtëzakonshme. Unë kam pas një përvojë me ligjet e shteteve pos komuniste, të cilat shumë shpejt kanë que dorë prej krenarisë së prodhimit të këtij arti ,i cili ka ndikua për mbrapshtë në civilizimet e veta me përjashtim të opozitarëve filmin çek, polak, hungarez edhe besa në disa vende të ish- Jugosllavisë. Rastin më eklatant e kemi ato debate kanë qenë,. kam qenë i vetmi edhe s'jam pajtuar në dëgjimin e fundit, këtu kemi pas përplasje. Jam pak donkishot dhe mendoj që klanizimet tona na bien në këtë situatë t'i ndërrojmë dy – tri nene, sepse ligji nuk funksionon. Tash ditëve të fundit kemi ardhur në pikën që kanë të gjitha shtetet. Të gjitha qendrat kombëtare të filmit janë themeluar nëpër Evropë pos komuniste, nuk po flas për Evropën Perëndimore.Edhe filmi është një lazdrim nacional, është

një mbretëreshë e arteve e cila me fuqinë e vet depërtimit të shpejtë ka ndikim të jashtëzakonshëm në ringjalljen, në rastin konkret, ringjalljen tonë nacionale përmes një filmi të prezantohemi në botën e jashtme, por edhe të marrim.

Në kesi raste vazhdimisht qendrat kombëtare të filmit kanë qenë nën juridiksionin ose nën kontrollin e Qeverisë, në kontrollin e kryeministrit. Drejtori i Qendrës Kombëtare gjithmonë është dy vjet, sepse fillon menjëherë klanizimi, përplasje interesave, kështu këto dy elemente i kam luftuar në atë kohë, po për fat të keq u **mbizotova** dhe unë e nderoj demokracinë.

Unë sot e kam dëgjuar këtë dëgjim publik, sepse nuk po shkon puna. E vetmja hapësirë në Evropë është se s'prodhon film, përveç dy filmave me çykë zori, me njëqindmijë përplasje, me njëqindmijë trauma u realizuan. Ndërsa, po e marrim shembullin e Shqipërisë prej 94-tës kam qenë pjesëmarrës edhe në këtë ligj atje, por atje për fat të mirë kanë traditën e shtetit të realizohen sendet. Një send i thjeshtë nuk bëhet anije kozmike po shumë send i thjeshtë, vetëm duhet një kujdes sikur rasti i juaj z. kryetar i këtij Komisioni, sepse kemi edhe Ligjin e Televizionit Publik që harxhohen nga 20 milion në vjet, palla s'i ha, kërkuat, në 2005 ka kaluar, kërkuat s'e ka dert atë punë. Faleminderit edhe njëherë po them që na ke thirr këtë ditë.

Unë e kam kuptuar ardhjen këtu që na shumë shpejt do të reagojmë, sepse kanë me u rregullua tri- katër nene që ky ligj të bëhet funksionali Qendrës Kombëtare prej një buxheti 02%, 01% sa ka pare buxheti i Kosovës ndahet për filmin sikur që ndanë kryeministri për shtëpitë e fukarave, për minoritetet, për sigurinë, Janë disa elemente që çdo shtet demokratik parlamentar të Evropës i ka funksionet që i ka kryeministri.

Kryeministri, kryetari janë eminencat të çdo partie, të çdo Parlamenti. Nuk ka aty klanizime grupeve të caktume rreth ministrit. Rreziku i parë i vetëm që ky ligj në Evropë ka kaluar në këtë mënyrë edhe në post.-komunizmit ka qenë, sepse ministri mund të jetë një llobist brenda partive të caktume i krahut kulturor edhe me vetë faktin që merr një buxhet prej Qeverisë 1 milion euro ndamë prej Qeverisë, i **detashohet** ministrit po e zëmë për filmin, ai pastaj me dijen e vet për artet, me klanin e veta lufton drejtorin e Qendrës Kombëtare, e pengon për me ia rrjedh paret dhe me u prodhua filmi, këtu humbin artistat. Ndërsa drejtori i Qendrës Kombëtare kur bëhet buxheti i shtetit këtë e ka krejt Evropa, merrni ligjet e Qendrës Kombëtare të Evropës, shihni, kështu është. Ai kryeministër në bazë të buxhetit 700 milion, 1 miliardë ndahen 02% për filmin ja **detashon** Qendrës Kombëtare. Drejtori i Qendrës Kombëtare nuk ka mekanizëm me ia dhënë gjithkujt. Cakton një bord, i vlerëson projektet. Vlerësohen projektet, e marr vendin e parë ia nisi me bë filmin. Kemi rastin e ministrit. Ministri i kaluar nuk më ka dashtë.. Unë edhe Fadil Hysa e kemi marrë vendin e parë në skenarë.

Pare s'kemi marrë prej vitit 2004. E kam marrë skenarin e parë për filmin dokumentar m'i ka dhënë 400 euro shpërblim, marre për neve. Vrasin në prag të shpisë, unë henez tash i marrë disa pare me i xhirua për eminencën e themelimit të demokracisë në Kosovë, sepse ministrit s'i pëlqej. Po të ishte drejtor i Qendrës Kombëtare unë e kam fituar vendin e parë, i marrë parat dhe e bëjë filmin. Me qenë se televizionet na i keni bllokuar na i keni lënë televizionin publik diletantin ,një njeri që na fynë, nuk na lenë me prodhu kurxho aty shkojnë 10 milion euro edhe juve ju bje ky Komision për Media aty i keni ligjin 2005 e kemi kalua, nuk jeni në gjendje me e themelua një bord me votua në Parlament e me i hjek një kriminel. Edhe këtu sot e kam kuptuar që vi në këtë eminencë të juve ,fundi i fundit keni marrë votë prej këtij populli mos na i nxini jetën edhe me dëgjime të tjera katra na mujmë me e kryjmë 4 nene .në mënyrë konkrete janë.. Krejt defekti është, le të çojnë letra gjithë ditën e gatë ata djem të rinj jam me ta bashkë. Defekti është i vetëm, që ky ligj duhet me i përngja krejt ligjeve të Evropës Juglindore. Për 10 vjet Shqipëria i ka prodhuar 40 filma, i ka marrë 46 shpërblime. Ministër i Kulturës ka qenë Dhimitër Agnosti. Po të mos ishte Qendra Kombëtare e Filmit regjisor i më i mirë ai i jepte paret vetë vetes si ministër me bë film. Po drejtori i Qendrës Kombëtare ishte i PSS-ës ipte konkursin- fitoi PDS-ë. Tash drejtori është i PDS për shembull e cakton kryeministri vokacionin e një partie, po drejtori i Qendrës Kombëtare shpërblen në .bazë projekteve. Komisioni është vlerësues i eminencës krijuese.Ai i vlerëson projektet, drejtori i menaxhon ato pare edhe na e ngrehë veshin, a po rrejmë a s'po rrejmë, a kam fonde të rrejshme nëpër banka, a kush jam a çka dreqi jam edhe prodhohet filmi. Kur prodhohet filmi janë festivalet jem konkurrencë botërore dhe jemi ata që ekzistojmë.

Me vetveten me klanizimet, me mossingeritetin, me demagogjinë që e bëjmë vetvetes edhe fëmijëve tanë, tash kemi rrezik edhe fëmijë e ju jo më veç vetveten sa na shkumë në drejt të mallkum. Është ardhur ky moment, nuk botohet libër, nuk organizohen festivale. Ekziston një fakultet i arteve që prodhojnë regjisorë të rinj 25 regjisorë janë me nga tetë filma rrinë rrugëve. Ata janë fëmija e ju, ato janë vajzat e juve, çdo gjë një nënçmim një katrahure e kemi lënë mafinë, e cila ka kap shtetin, për shkak se s'e bëjmë ligjin. T'u kisha lutë z. kryetar, në qoftë se i ke hulumtuar ligjet e qendrave kombëtare s'na vënë as ministri as kërkush, vënë Parlamenti ligji unë kam thanë edhe shokëve. Vetëm në Parlamenti na duhet me i rëzua ato nene të këqija për me e çu edhe një herë në Parlament me votua se nuk ka procedurë tjetër, s'e kemi votuar me vota 100% kështu e kemi votuar. Kemi kërkuar qashtu, paret me ja çu ministrit, e ministri me vendos. Me ja çua drejtorit të Qendrës, me thirrë në telefon, me i shpërla pak paret, mi fry sendet krejt merak në lekë. Kështu që unë propozoj që sot ta kryejmë nen për nen.Defektet e neneve t'i rregullojmë, t'i votojmë sikur që kemi votuar prapshtë në bazë të interesave politike të individëve të caktuar. Definitivisht të mësohemi t'i nderojmë ligjet që kanë dhënë suksesin në shtet tjera ato janë për rreth Hungari,,

Bullgari, Rumuni. Mali i Zi për gjashtë muaj ditë e ka bërë këtë ligj, që s'ka ba shtet, vjet e ka marrë pavarësinë për gjashtë muaj ditë e ka bërë ligjin. Një kryetar i Grupit Parlamentar kaq vënë me një nënkryetar i mëshojnë tavolinës dhe kryhet kjo punë, nuk ka këtu Kaq e kisha, më falni.

KRYETARI I KOMISIONIT ENVER HOXHAJ – Ju faleminderit. Edhe unë i kërkoj falje përfaqësuesve të Unionit të Artistëve. Në përputhje edhe më mënyrën se si kemi reaguar definitivisht fjala do t'i duhej t'i takonte fillimisht Unionit të Artistëve. Po meqë ne si Komision merremi me arsim dhe shpeshherë kemi punë me njerëz të arsimit, të kulturës edhe të sportit ose përfaqësues të rinisë, shpeshherë synojmë ta kemi një qasje të barabartë ndaj të gjithëve, kështu që ia jep fjalën përfaqësuesit të Unionit të Artistëve të Filmit, me qëllim që të vërtetë këtë dëgjim publik ta shtron në mënyrën, ta shtron nevojën edhe një herë rreth asaj se çfarë na si Komision në formën konkrete kishim mund ta ndihmojmë implementimin ose edhe amendamentimin e këtij ligji. Të shohim se kah po lëviz debati në këtë dëgjim publik.

Së pari unë jam Blerim Gjoci, këtu jam në cilësinë e kryetarit të Unionit të Artistëve të Filmit. Kisha me përshëndet këtë Komision për reagimin e shpejtë që e kanë bërë. Faleminderit për atë që po na dëgjoni.

Unë këtu jam që t'i përcjell shqetësimet në emër të Unionit të Artistëve të Filmit, do me thanë anëtarë të cilit jemi shumica këtu. Në letrën që kemi dërguar ne kryesisht aty kemi shpreh shqetësimet tona. Besoj se atë letër e keni lexuar të gjithë. Për gjithë ata që nuk e kanë lexuar e kisha me elaboru në mënyrë shumë shkurt për punë mos me u zgjatë.

Ne, në Ligjin për kinematografi, i cili nuk mund të themi se është ligj i përkryer, mirëpo nuk mendoj që ka një ligj të përkryer diku dhe secili prej neve i kemi vërejtjet tona në lidhje me atë ligj. Mirëpo, ai ligj sado i brishtë që është neve më së shumti si union na ka mundu fakti që ai ligj aq i brishtë sa është vazhdon të shkelet në mënyrë flagrante. Kjo është ajo që më së shumti na ka shqetësuar deri më tani.

Ne si Union i Artistëve të Filmit kërkesën primare që e kemi pas atë ligj aq të brishtë sa është ta respektojmë. Unë mendoj që ai ligj do të mundësonte punën në film dhe do të mundësonte avancimin e kinematografisë në Kosovë. Do të mundësonte shumë gjëra të cilat ne si artistë të filmit vuajmë që t'i bëjmë. Mirëpo, përveç asaj, mospërfillja e atij ligji ka çuar edhe në keq menaxhimin edhe keqpërdorimin e fondeve në Ministrinë e Kulturës, fondeve të dedikuara për film. Ato fonde të vogla sa janë, janë nda në mënyrë jo transparente, d.m.th. vazhdojnë të jepen për projektet të cilat nuk i aprovon askush do me thënë thjeshtë dikush në Ministrinë e Kulturës vazhdon të menaxhojë Fondin për Kulturë sikur ta kishte

fond të shtëpisë së vet, vetëm pa e pyetur askënd se ku shkojnë ato fonde dhe kujt i dedikohen.

Këto janë shqetësimet të cilat më së shumti neve na kanë munduar dhe për atë arsye ne e kemi dërguar letrën në të cilën kemi kërkuar përgjegjësi për mosrespektimin e Ligjit për kinematografi që vazhdon që katër vite. Do me thanë së pari mos krijimi i Qendrës për Kinematografi si rregullator i kinematografisë në Kosovë dhe më vonë pas formimit të saj mos funksionalizimi i kësaj qendre ,e cila vazhdon të jetë vetëm si hije dhe nuk mund të funksionojë.

Ne një përgjigje që kemi marrë nga Ministria e Kulturës, e cila na ka ardhur para dy ditësh, në fakt para tri ditësh, në këtë përgjigje ne nuk kemi marrë asnjë përgjigje konkrete dhe asgjë konkrete se kur do të funksionalizohet Ligji për kinematografinë dhe kur do të funksionalizohet Qendra Kinematografike si rregullator i kinematografisë. Ne krejt çka kemi marrë është një zhargitje dhe një shtyrje të zgjidhjes. Në asnjë moment nuk ka pas zgjidhje në këtë letër që kemi marrë nga ministri. Ministri këtu thotë që ka për qëllim bashkëpunimin me artistët dhe ne shpresojmë që kjo të jetë e vërtetë. Mirëpo, ministri në asnjë moment nuk ka pranuar që të na takojë dhe kjo na shtinë pak me dyshua në të gjitha këto.

Mirëpo, ne megjithatë jemi në gjendje të takohemi dhe të bisedojmë dhe faleminderit prej juve, në mënyrë që ta ringjallim kinematografinë. Nuk është qëllimi jonë të akuzojmë askënd, qëllimi jonë është të ringjallim kinematografinë, sepse shqetësimet e Unionit të Artistëve të Filmit janë se artistët e filmit janë në shkallën më të ulët që nga përfundimi i luftës e deri më tani.

Po ashtu përveç artistëve edhe kinematografia kosovare është në shkallën më të ulët jo për faktin e mungesës së talentit, por për faktin e mungesës së punës. Do me thanë, asnjë prej artistëve, siç e tha edhe parafolësi ka dy vite faktikisht janë vetëm dy filma që prej pas luftës janë krijuar me mund, dy filma po flas se metrazhi të gjatë me 35 mm dhe prej atëherë Kosova nuk ka prodhuar më film.

Janë dhënë fonde për film, por film nuk ka pas. Prandaj, ju kishim lutur që të përdorni ndikimin tuaj që diçka të bëhet në mënyrë që të ringjallet kinematografia në Kosovë.

Në letrën e ministrit se nuk do ta zgjati thuhet që është i gatshëm për bashkëpunim e ne po i themi që edhe ne jemi të gatshëm për bashkëpunim së pari të fillon të respektohet ky ligj e pastaj të vazhdojmë më tutje. Faileminderit.

KRYETARI I KOMISIONIT ENVER HOXHAJ – Ju faileminderit z. Gjoci. Urdhëroni.

LIRAK ÇELAJ - Faleminderit. I përshëndes anëtarët e Komisionit dhe gjithë prezentë që janë këtu. Mendoj që është një nismë e mirë do të thotë kjo që keni reaguar kaq shpejtë ndaj kësaj shkrese, sepse ne ndihemi pjesa artit përgjithësi ndihemi shumë të lanun pas dore e më së shumti nga institucionet që duhet të merren me neve, janë të themeluara për t'u marrë me neve ato më së shumti na injorojnë. Kështu që kjo nismë është një hap pozitiv dhe besoj që nuk do të mbetet vetëm me debat ,por do të merren edhe masa konkrete.

Unë nuk mendoj që është problemi i dy- tre amendamenteve ,si tha Fahriu. Unë mendoj që problemi është më i thellë se sa kaq edhe nuk është puna që po shkelet ligji që po thotë Blerimi, por është moszbatimi i asnjë pike të ligjit. Ligji është aprovuar në këtë Kuvend dhe mund të filloni prej neneve të para të shihni ku flitet për licencimin, për ato etiketat kontrolluese, për importin, për kinematë, për të gjitha këto, asnjë prej këtyre nuk zbatohet asnjë. Nuk është vetëm shpërndarja ose vetëm Qendra Kinematografike që nuk funksionon, asnjëri prej këtyre.

Unë e di vetëm që është zgjedh vetëm kryetari i Qendrës Kinematografike, i cili është prezent këtu, por nuk është zgjedh edhe këshilli drejtues dhe organet tjera, të cilat do të duhej t'i bënte Ministria. Praktikisht, asnjë përpos zgjedhjes së drejtorit, asnjë hap tjetër nuk është ndërmarrë në këtë drejtim. Prandaj nuk është fjala vetëm për moszbatim ose për ndërrim të një neni ose dy, por thjeshtë këtu është një problem më i madh, moszbatimi i ligjit.

Prandaj, mendoj që Parlamenti duhet ta ushtrojë ndikimin të cilin fatkeqësisht nuk po e ushtron jo vetëm në fushën e kulturës, por edhe në fusha të tjera të kontrollit të ekzekutivit që është detyra primare e Parlamentit. Nëse Parlamenti ka nxjerr një ligj ai është obligim për Ministrinë dhe për Qeverinë për ta zbatuar. Në qoftë se këtu janë dhënë në fund dispozitat kalimtare afatet se kur duhet të zbatohen këto ligje ku shkruan që duhet pas 6 muajve, njëra-tjetra prej 6 muajve, tjetra pas 3 muajve kanë kaluar vitet ,atëherë këtu është një problem më i madh se sa një nen ose diçka tjetër. Prandaj,ja edhe sot mos prezenca e asnjë anëtarë që ministri që nuk qenka këtu, a ka zëvendësministër? A ka drejtorë tjerë të niveleve tjera, këshilltarë a dikush që do të mund të vinte të na epte disa sqarime më zyrtare,sepse nuk zbatohen. Injorimi i Parlamentit edhe i artistëve është diçka shumë shqetësuese. Prandaj mendoj ju si Parlament duhet të ushtroni ndikimin e juaj ne ekzekutivin që të zbatohet ligji. Vetëm kaq. Momenti që fillon mu zbatua ligji atëherë na mund të flasim për nene të vogla ku nuk funksionon. Ne ende nuk e dimë çka funksionon çka jo, sepse nuk ka pas kurrfarë tendence që të funksionalizohet. U dash të bëhet një shkresë, të shkruajnë mediat, që në fund ministri tha që i ndava 100 mijë euro do me thanë pasi po bëhet zhurmë ka mundësi të ndahen, do të thotë është thjeshtë një injorim i krejt këtij problemi.

Para një viti kur kam kritikuar ministrin që nuk po bënë asgjë për ta rritur buxhetin që është më i vogli në rajon, buxheti i kulturës, ai ka deklaruar që ka kaluar koha e komunizmit kur investohej në kulturë, kurse tash ankohet që s'ka buxhet .Do të thotë unë mendoj që nuk është problemi më veç te buxheti, por është edhe te lobimi që nuk ka pruar projekte konkrete, nuk ka insistua në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave në Komision kur hartohet, Parlamenti që të rritet ky buxhet nuk ka qenë bindës.

Prandaj unë mendoj që duhet ky problem të shihet në nivele tjera e mandej të vijmë te amendamenti. Unë mendoj që ka shumë, më shumë se tre- katër amendamente që duhet ndryshuar në këtë ligj, por megjithatë ai do të duhej të ishte procedurë më vonë, pasi të aprovet apo funksionon ky ligj apo jo. Thjeshtë nuk ka pas kurrfarë tendence të funksionojë. Në qoftë se Komisioni për Ekonomi dhe Financa ka dhënë pëlqimin se nuk ka implikime buxhetore, atëherë ata kanë thënë që ka mundësi që të zbatohet dhe arsyetimi se nuk ka buxhet për të funksionalizuar ky ligj është i papranueshëm dhe nuk qëndron aspak.

Kështu që mendoj që duhet të bëni presion shumë të madh te ministri që të zbatojë ligjet, vetëm kaq e mandej mund të hymë në amendamente dhe në rregullimin e ligjit përgjithësi. Kaq, faleminderit.

KRYETARI I KOMISIONIT – ENVER HOXHAI - Ju faleminderit z. Çelaj - A donë dikush tjetër fjalën? Urdhëroni.

JETON BUDIMA – regjisor. Do të mundohem,pasi që jemi të kufizuar pak në kohë, do të mundohem me qenë më tepër konkret, më tepër preciz, në krahasim me ekspozicionin që është thënë më herët, sidomos nga fjala e Fahriut.Fjala është për ato informata që ne i kemi dëgjuar shumë më herët, i kemi lexuar shumë më herët, por problemi është me definuar motivin pse po ndodhë kjo. Në situatën në të cilën gjendem, ndodhë edhe shkelja e ligjit, mirëpo edhe mungesa e implementimit të ligjit. D.m.th. shkelja e ligjit zhvillohet në kontinuitet prej vitit 2002,d.m.th. prej atij momenti ku sponzorohet projekti i parë, e shumë mirë dihet në çfarë bazash është sponzoruar projekti i parë, d.m.th.projekti i parë është punuar nga Sonai Raça, një regjisor amator,d.m.th. një regjisor pa diplomë. Mirëpo normalisht ky projekt është zhvilluar në baza kanore. Dhe normalisht, po ashtu, në vazhdimësi,d.m.th. në raport me shkeljen e ligjit është prezente edhe mungesa e implementimit të ligjit në 365 ditët e para.

Domethënë kjo përgjegjësi është e dyfishtë, përgjegjësia nuk i takon vetëm Ministrisë së Kulturës,qysh prezantohet ,mirëpo i takon edhe Qendrës Kinematografike të Kosovës, d.m.th. përgjegjësi është paralele. Poenta nuk është vetëm te sigurimi i buxhetit, d.m.th. një buxheti objektiv të sigurohet me çdo

kusht, mirëpo poenta është te mungesa e këshillit drejtues që u përmend më herët prej Lirakut, mungesa e statutit, mungesa e rregulloreve, mungesa e taksave, të cilat janë në gjendje ta sigurojnë një buxhet intern, një buxhet potencial, i cili nuk lidhet në një mënyrë drejtpërdrejtë me shkarkimet të cilat kërkohen p.sh. nga ministri i Kulturës.

Në sa e di unë në 365 ditët e para nuk ka ndodhur asgjë. Unë në 360 ditët e para nuk e kam lexuar p.sh. një propozim, një zgjidhje të hairit. Zeqa, p.sh. Hamiti thjeshtë në 365 ditët e para faktikisht nuk ka vepruar konkretisht asgjë. Domethënë heshtja e tij në princip e lidh me strukturat ekzistuese të Ministrisë së Kulturës. Heshtja e tij në princip e lidh me manipulimet dhe spekulimet me korrupsionin, i cili kryhet në Ministri të Kulturës. Nëse Zeqa ka menduar ndryshe d.m.th. ai thjeshtë ekzistojnë shumë medime ku mund të tregohet kjo. Thjeshtë, problemi nuk është vetëm te buxheti. Problemi është mënyra se si përdoret truri, d.m.th. këtu faktikisht ka njerëz që janë në gjendje me përdorur trurin ashtu si duhet, mirëpo kjo nuk po ndodh. Thjeshtë unë kisha kërkuar një përgjigje prej Zeqës pse po ndodhë kjo, pse p.sh. në 365 ditët e para mungon struktura, mungon këshilli drejtues dhe strukturat tjera me menaxhimin dhe sponzorimin e filmit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KOMISIONIT ENVER HOXHAI – Ju faleminderit z. Butina. A e doni fjalën? Urdhëro.

BEKIM LUMI – me profesion regjisor. Mendoj se çështja themelore qëndron ndoshta jo aq konkretisht te ky ligj nëse është i mirë ose i keq, sepse për këtë kemi diskutuar në kohën kur është miratuar ose për para miratimit të tij. Aso kohe janë dhënë disa vërejtje, shumica e tyre nuk janë përfillë nga ana e Kuvendit të Kosovës, për fat të keq dhe tash si rezultat e kemi këtë proces nëpër të cilin po kalon arti i 7 në Kosovë. Por, po supozojmë ose po e zëmë se ky ligj është shumë i mirë, i ka të gjitha përparësitë e veta, por çështja qëndron tek mungesa e dëshirës për zbatimin e këtij ligji. Do të thotë ne po ndërtojmë shtet, po ndërtojmë, po krijojmë ligje, mirëpo asnjë herë nuk po i respektojmë këto ligje. I theksuam disa nga problemet me të cilat zakonisht ndeshet ky ligj, ose artistët ose Qendra Kinematografike e Kosovës, përkatësisht Ministria e Kulturës në mungesën e dëshirës për zbatimin e këtij ligji. Unë do të ndalem në disa nene konkrete të cilat mbase mund t'ju shërbejnë juve si parlamentarë për evidentimin e problemeve që konkretisht dalin nga mungesa e zbatimit të këtyre ligjeve.

Së pari ka qenë problemi themelor për mua është do të thotë në çështjen e themelimit të Qendrës Kinematografike të Kosovës, e cila është krijuar me një vonesë të konsiderueshme. Ligji thotë se Qendra Kinematografike e Kosovës themelohet diku tre muaj pas miratimit të këtij ligji. Ndërkohë që ky ligj me sa po e shohë unë është miratuar me 3 korrik 2004, ndërkaq ne e dimë që Qendra

Kinematografike është themeluar tek përpara një viti në qoftë se nuk gabo, do të thotë kemi një vonesë dy vjeçare. Si rezultat i krejt kësaj tani kemi edhe problemet tjera që janë reflektuar për shkak të kësaj vonese. Thuhet ,po ashtu, se emërimi i këshillit drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës ,që në të vërtetë është promotori i zhvillimit të kinematografisë në Kosovë, i miratimit të fondit për kinematografi, i miratimit të jurive, të komisioneve përkatëse i vlerësimit të projekteve të ndryshme e filmime, do të thotë pa themelimin e këtij bordi apo këshilli drejtues realisht nuk mund të kemi prodhim të kinematografisë në Kosovë. Kjo ende nuk është bërë. Nuk e di për çfarë arsye, nuk janë tre muaj nga koha e themelimit të qendrës kinematografike, por janë diku gati një vit, për të ndoshta mund të flasë drejtori i Qendrës Kinematografike ma konkretisht se ku ka ngecë puna, pse nuk themelohet ky këshill, mund të jenë arsyet e natyrës materiale nuk e di se çfarë, përmendet edhe kjo, mirëpo rezultatin konkret e kemi se ne sipas nenit 48 thuhet se Qendra Kinematografike ka fondin për kinematografi, do të thotë Qendra Kinematografike nuk ka. Kemi një shkelje të nenit 48, kemi një shkelje të nenit 60, sipas të cilit thuhet se po ashtu emërimi i këshillit drejtues bëhet në një afat prej 3 muajsh,pas themelimit të Qendrës Kinematografike të Kosovës, do të thotë shkelet edhe kjo. Kemi nenin 60.1 sipas cilit thuhet se Ministria e Kulturës miraton aktet nënligjore brenda 6 muajsh pas themelimit të Qendrës Kinematografike të Kosovës, shkelet neni 60.1. Kemi nenin 60.2, sipas cilit thuhet se Qendra Kinematografike e Kosovës miraton aktet e veta brenda 6 muajsh. Kërkoj falje, ndoshta nuk jam në dijeni, por me sa di të paktën publikisht nuk kam parë nëse është miratuar ndonjë akt ose jo, por këtë nëse ka diçka të miratuar nga kjo, për këtë mund të na flasë drejtori i Qendrës Kinematografike ,nëse jo atëherë konsideroj se ky nen po ashtu po shkelet.

Pastaj janë disa nene të tjera të cilat nuk reflektohen drejtpërsëdrejti në çështjen e prodhimit të filmit, po që kanë të bëjnë me funksionalizimin e këtij ligji. Bie fjala kemi nenin 25.7. Qendra Kinematografike e Kosovës krijon dhe përditëson të dhënat për krijimtarinë filmime në botë tjera. Unë nuk e di se çka është nënkuptuar me këtë dhe në çfarë mënyre do të bëjë përmes një Ueb sajditë përmes broshurave, botimeve e ndryshme, të cilat eventualisht mund t'i krijonte Qendra Kinematografike e Kosovës. Mirëpo deri sot nuk kemi rezultat konkret, kështu që konsideroj se ka një shkelje po ashtu të nenin 25.7 të Ligjit për kinematografinë.

Dhe si rezultat i kësaj neni 28 organet drejtuese. Përveç drejtorit të Qendrës Kinematografike të Kosovës, deri sot nuk ka asnjë organ tjetër të zgjedhur të Qendrës Kinematografike të Kosovës. As të Komisionit, as të këshillit drejtues, as të komisioneve apo të jurive përkatëse, të cilat do të merreshin me miratimin e buxhetit apo me miratimin e projekteve konkrete.

Dhe, ndoshta një problem tjetër periferik që tash na ka dalë si rezultat i keqkuptimit që ka krijuar ky ligj ,sidomos me çështjen e Kosova Filmit. Aso kohe

kemi diskutuar debat mjaft të nxehtë, mirëpo ka shkuar ashtu si ka shkuar në versionin qysh është propozuar nga ana e themeluesve të këtij ligji ai projekt, mirëpo sot na ka dalë problemi me Kosova Filmin që nuk dihet saktë statusi i tij, për deri sa drejtori i tanishëm i Kosova Filmit insiston në një akt nënligjor të miratuar nga ish -ministri Brajshori, sot Ministria e Kulturës e thirrur në kompetencat që jep ky ligj, miraton një akt tjetër dhe definon ndryshe statusin e Kosova Filmit. Unë mendoj se edhe ky është problem i hartimit të keq të këtij ligji përkatësisht, i nënkuptimeve, i shtresave të dykuptimshme, apo të shumëkuptimshme të cilat ligjet e caktuara lënë dorë gjithë herë për me i keqinterpretuar ose për me interpretuar ashtu si dëshirojmë ne. Ju faleminderit.

KRYETARI I KOMISIONIT ENVER HOXHAJ – Ju faleminderit z. Lumi. Z. Hamiti e keni fjalën.

ZEQIR HAMITI – drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës-së.

Këtu kam ardhur të dëgjoj kolegët, njerëzit që merren me veprimtari kinematografike, dhe të shpjegojë ose të shpjegohem lidhje me mosfunksionimin apo me problemet që shtrohen në funksionimin e qendrës kinematografike të Kosovës.

Ligji për kinematografi është një ligj i cili është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në korrik 2004, dhe aty parashihet si institucion qendror për zhvillimi e kinematografisë, dhe themelimi qendrës kinematografike të Kosovës. Është një praktikë e vendeve ,zakonisht sepse konsiderohet se kinematografia është një fushë veprimtari shumë e kushtuar por shumë e rëndësishme për zhvillimin e kulturës, dhe është konsideruar si strategji ta quajë ashtu kulturore. Ndërsa në vendet e Lindjes ka pas ndërmarrje shtetërore për prodhimin e filmit të cilat i ka financuar 100% shteti.

Themelimi i Qendrës Kinematografike të Kosovës ka pas për qëllim kur është themeluar, kur është shkruar autorët e përpilimit të këtij Ligji, kanë pas parasysh edhe përvojat e Shqipërisë ku vetëm 10 vite përpara është konstituuar, **ndërtuar Qendra Kinematografike e Kosovës.**

Unë nuk do të flas për nenet e veçanta ose për ligjin, sepse ligji është miratuar edhe mund me një të ardhme të amandamentohet, të shihet si funksionon, ose nuk funksionon . Brenga ime gjithashtu është shumë më e madhe se e kolegëve në lidhje me mosfunksionimin e Qendrës Kinematografike të Kosovës.

Qendra Kinematografike e Kosovës mund të them që është themeluar vetëm simbolikisht. Unë kam bërë përpjekje normalisht, duke qenë institucion i varur nga Ministria e Kulturës, të kem kontakte me Ministrinë përkatëse, me tre njerëzit

kryesorë që merren me këtë fushëveprimtari. Drejtorin ose drejtoreshën e Kulturës, sekretaren permanente, ose të përhershme e cila kujdeset për zhvillimin e institucionit dhe natyrisht me ministrin i cili përgjigjet për politikën kulturore. Unë nuk kam dashur komunikimin tim me një institucion prej të cilit jam varës, ta bartë nëpër gazeta dhe me deklarata shterpe, mirëpo unë i kam kryer punët në raport me Ministrinë e Kulturës. Qysh në fillim kur jam zgjedhur, do të thotë maji duku ka qenë, unë me kërkesën, sipas kërkesës së sekretares së përhershme zonjës Zana Kryeziu drejtori i Qendrës Kinematografike të Kosovës QKK, Zeqir Hamiti paraqet

Objektivat për konstituimin dhe zhvillimin e QKK-së. Unë e kam tekstin që ua kam dhënë. Është e shkruar Prishtinë, 30.5.2006, sa për këta që i donë këso informata. Nenin do t'ua citoj më tutje. Këshillin drejtues të QKK-së, si organ drejtues honorifik, këta njerëzit po i japin këta kolegë pak si rëndësi pak më të madhe se që e ka, me nenin. tash e kam nenin, do ta citoj: E miraton ministri i Kulturës. Z. drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës më 20 gusht 2006 i drejtohet Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit për ministrin z. Astrit Haraqia, lënda: Zgjedhja e anëtarëve të këshillit drejtues të QKK-së. Propozoj këta anëtarë për këshillin drejtues të QKK-së, emrat, të gjithë anëtarët e këshillit drejtues janë të jashtëm honorifik, honorari i tyre caktohet, këta zgjedhën me mandat 3 vjeçar me mundësi do të thotë duke e cituar ligjin. Më datën 20 gusht 2006, meqenëse më është thënë në vitin kalendarik në vitin e kaluar nuk ka mjete për Qendrën Kinematografike që është themeluar, megjithatë unë e kam bërë një kërkesë për mjete, ta quaj emergjente, e cila më është miratuar, zonjës sekretare Zana Kryeziu dhe për njoftim ministrit të Kulturës të Kosovës z. Astrit Haraqija, t'i ndahen mjete financiare QKK-së, data 20 gusht 2006. aprovohet -Zana Kryeziu 14.9. mjetet të cilat bëhet fjalë për mjete 27150 euro për hapjen e konkursit për këshillin drejtues për anëtarët e jurive për vitin e kaluar, do të thotë ka qenë e miratuar paret nuk janë ndarë me arsyetim se nuk ka kohë.

Tjetër, në tekstin: Objektivat e zhvillimit, konstituimit, do të thotë ndërtimin edhe e QKK-së kam propozuar, duke pasur parasysh edhe strukturat organizative të Qendrës Kinematografike të Shqipërisë para se gjithash, se ajo është me një strukturë më të vogël, kam propozuar ndërtimin..... do të thotë ministri e aprovon organogramin ose organikën e QKK-së me propozimin e drejtorit. Është një nga obligimet që ka ministri. Sipas nenit 28.2 të Ligjit për kinematografi jam i lirë t'jua prezantoj organogramin e QKK-së edhe i kam kërkuar 5 punëtorë, Prishtinë, 12.2.2007 drejtori Zeqir Hamiti, do të thotë organogrami.

Në vitin e kaluar ka pas përpjekje për lëvizje horizontale të kuadrove, sepse më është thënë që Ministria e Kulturës Rinisë dhe e Sportit ka tepërcë punëtorësh dhe do të ishte mirë qysh në vitin e kaluar tepërica e tyre të kalonin në Qendrën Kinematografike. Unë kam kundërshtuar dhe kam thënë se pa një konkurs publik

nuk do ta bëjë, ju jeni të lirë dhe jeni institucion mund t'ju lëshoni kontratë të bëni pa konkurs publik unë nuk i marr.Kjo është, sepse kam propozuar që duhet të jetë strukturën organike në 5 veta po ju them. Menaxheri ose menaxherja, përgjegjësi sekretari, ose sekretari ose përgjegjësi një jurist, një financier që përgjigjet edhe për ekonomi, një asistente, ose asistent, dhe një shofer.

Do të thotë edhe kam kërkuar që këta njerëz duhet të kenë përgatitje përkatëse dhe të kenë njohuri në zbatimin e ligjit, të ulen t'i shkruajnë bashkë rregulloret se unë nuk jam jurist, nuk mundem pa bashkëpunim, edhe kjo ka qenë. Unë,në mënyrë krahasimtare i kam konsultuar ligjet ekzistuese dhe rregulloret edhe statutet e Qendrës Kinematografike të Shqipërisë, e kam parë në Zagreb si kanë punuar, në Beograd si kanë punuar dhe në rregullore tjera nuk kam pas. Praktikisht me përjashtime shumë të vogla janë të njëjtat ,sepse janë të marrur prej një mostre ose prej një arkeligji që e thashë më përpara, është mënyrë e njëjtë e organizimit.

Qysh në fillim në korrik e kam propozuar strategjinë edhe programin të cilin duhet ta zhvillojë Qendra Kinematografike. Po flas me dokumentet të cilat jam i obliguar ndaj Ministrisë t'i shpjegojë. Kam kërkuar më datën 8.12. do të thotë gjatë dhjetorit e kam çue. edhe tekstin ose projektin, projektbuxheti dhe politikat programore për vitin 2007, Qendra Kinematografike.

Ia kam dorëzuar drejtoreshës së Kulturës zonjushës Alberta Tronin me të cilën kam diskutuar dhe ia kam dorëzuar ministrin të cilin personalisht nuk e kam takuar, por zonjës së kabinetit të tij. Do të thotë ku paraqitet që unë si objektiva i kam paraqitur realizimin ose bashkë realizimin e dy filmave të metrazheve të plotë, tre filma të metrazhit të shkurtër dhe të mesëm artistik dhe pesë filma dokumentarë. Do të thotë për këto në bazë të çmimeve përafërsisht të kostos në mënyrë të përafërt është bërë dhe janë kërkuar diku për pikat 1, deri 11 që i kam sistemuar , një milion e gjashtëqind e njëzetmijë, për shërbime, mallra dhe për funksionalizimin e institucionit 92 mijë euro. Kjo është bërë në dhjetor të vitit të kaluar. Këto janë ato që unë normalisht dokumentet që janë zyrtare edhe të miratuara, nuk po i lexojë nuk bënë normalisht nuk janë çështje e gazetave e raporteve se nuk dua ta zhvillojë me një institucion, një praktikë të cilën ata e zhvillojnë ndaj institucioneve të veta të komunikojnë politikën e vetë ta bëjnë çështje të pazarit të ditës, po duhet të mësohemi në mënyrë institucionale, unë ju kam thënë zotërinjve të ministrisë, unë jam i gatshëm të më thërrisni t'ju jap llogari për punën e bërë edhe për atëPrandaj, konsideroj pa plotësimin e organikës asnjë hap nuk mund të bëhet mëtutjeshëm, pa pranimin e këtyre pesë punëtorëve me konkurs publik.

Çështja tjetër është, pa fond nuk mund të bëhet edhe një hap, unë zotërinjve që merren me këtë punë ju tregojë që me 9.02. e kam shkruar edhe e kam formuluar

konkursin për projekte, qendra kinematografike e Kosovës shpallë konkurs ju lutem.

Për financimin e pjesshëm të projekteve filmike, financim i pjesshëm ose bashkë financim i projekteve kinematografike për vitin 2007, konkursi hapet për këto kategori, dhe krejt kushtet, dhe skemën i kam marrë konsultuar tri qendra qysh bëhet, dhe çka kërkohet dhe cili dokumentacion dhe çka kërkohet, do të thotë është bërë me datën 9 shkurt. As nuk mund të hapet konkursi, unë në llogarinë time që ka qenë bërë proverbiale diçka një marrëzi mediale edhe këtu e kam hapur jo ministria, e kam hapur llogarinë dhe i kam qitur mjetet e para në mënyrë simbolike me e themeluar fondin ose fondin e institucioneve.

Në këto dy aspekte përveç bisedave dashamirëse të zonjës Kryeziu sekretare, as nuk është ndërtuar infrastruktura, është një zyre ju them shumë e thjeshtë. E kam një kompjuter i cili është marrë nga dikush është vu një telefon dhe një tavolinë. Kushtet minimale nuk janë për tu funksionuar një institucion i tillë.

Do të thotë, nuk ka mjete, nuk ka infrastrukturë, nuk ka të punësuar, krejt këto tjerat çka thonë janë çështje që mund të diskutohen, pa këto as unë si person as një hap nuk mund ta bëjë pa u plotësuar këto. Në vitin e kaluar kur thashë kam kërkuar të hapet konkursi, shpallja e konkursit për logo, shpërblime për fituesin e konkursit botime, juria për zgjedhëse sa është, punimi i vulës, sepse është një institucion që nis nga zeroja.

Nuk është nxjerrë as akti, mirëpo unë e kam dhënë në bazë të nenit 20 të themelohet kjo, pastaj kam kërkuar dhe kam hapur llogarinë do të thotë nuk janë bërë, shpërblime, honorarë, etj. e këto gjëra të tilla, unë ju them nuk jam ekspert për çështje juridike, kam mbledhur rregullore kam mbledhur statute të institucioneve simotra, ligjet i kam konsultuar disa herë e kam lexuar këtë ligj, nuk jam ekspert i interpretimit juridik të ligjit mirëpo, problemi si tha edhe Liraku ka probleme në ligj që më vonë ndoshta edhe një herë dy do ti them, është mos zbatimi elementarë i këtij ligji. Do të thotë qendra është e themeluar vetëm simbolikisht edhe nuk ka buxhet. Po ju them që unë jam ndodhë shumë shpesh edhe nën trusninë e njerëzve, edhe më thërrasin njerëzit: e ke lexuar filan gazete zakonisht kjo është pak si popullore, apo ke dëgjuar në filan gazetë që ka deklaruar akt cili njeri i ministrisë të tyre famshëm të informimeve nëpër gazeta që tu kanë ndarë kaq mjete, sot qenke veshur i bukur, dhe qenke i gëzuar se ti kanë ndarë do mjete se një gazet ka thënë, tjetra gazetë thotë, pardje, ka thënë ka thënë që ministri ia ka ndarë dikujt 600 mijë, qysh ti nuk po e din që ai, ia kishte ndarë, tjetra gazetë ka thënë 300 mijë. E me këtë botë, me këtë problem është, sepse njerëzit e Ministrisë duhet të komunikojnë me institucionet e veta, donë ta bëjnë administratë të institucioneve të veta Ministrinë, po institucionet për të vepruar të pavarura duhet ta kenë infrastrukturën brenda. Ato duhet të

kontrollohen, normalisht unë jam i gatshëm t'u jap llogari për funksionim – mosfunksionimin, mirëpo duhet t'i kenë minimumin e njerëzve që punojnë aty për t'i zbatuar dhe për t'i vënë në zbatim edhe rregulloret edhe ligjet. Kryesorja, për shokët, këta që meren me prodhimin e filmit, aspirantët e projekteve, ju them që kryesorja në vlerësimin e një projekti është juria përzgjedhëse dhe vlerësuese, e cila përbëhet prej 7 vetëve. Ajo do të bëhet me propozimin tim edhe miratohet nga Këshilli i artist, nga këshilli drejtues, do të thotë, krejt përgjegjësinë për përzgjedhjen ashtu quhet: vlerësimi dhe përzgjedhja bëhet nga një juri profesionale, rruga është shume teknologjia e zgjedhjes është shumë e rëndë, por është e mirë nga më të mirat që janë bërë, do të thotë në Shqipëri ekziston vetëm një juri e përzgjedhjes, këtu ka edhe këshill drejtues që edhe një herë e shikon ato programe, mirëpo kryesore është Këshilli – juria profesionale, që i vlerëson nga aspekti i ... dhe komisione financiare që e vlerëson koston e këtij financimi.

Një diçka tjetër po ju them: në një nen, tash nuk po e citoj nenet se diku neni 20 e sa, thotë që jo dy muaj më vonë se të jetë akorduar buxheti, qendra kinematografike e Kosovës shpall konkurs. Këtu nuk është akorduar asnjë buxhet as për shpërbimin me mallrave këtu as për projekte. Neni 48 thotë që, për zhvillimin e kësaj veprimtarie themelohet fondi për Kinematografinë, neni 48, ai nen, ai fond nuk është themeluar. Ai fond to të thotë është fond i projekteve, do të thotë nuk është fond që ka të bëjë me zhvillimin e institucionit, mirëpo vetëm ndarja e projekteve, do të thotë dihet Qendra kinematografike i ka në dispozicion në një vit kalendarik një milion, atëherë dihet në bazë të atyre shpallet konkursi, sepse këtu konkurrohet bëhet financimi i pjesshëm, që është jashtëzakonisht që ai neni i pari që duhet hedhë, unë mendoj që është, që i ven prodhuesit në Kosovë në rrethanat që krijohet kinematografia praktikisht në pamundësitë për ta fituar projektin, sepse kërkon nga producentët apo shtëpitë filmike t'i kenë 49% të mjeteve për bërjen e një filmi, në rrethanat e Kosovës, ku një film punohet prej 500 deri në 700-800 mijë euro, do të thotë një prodhues duhet t'i ketë 350.000. Në rrethanat ekzistuese nuk Kosovë nuk do të gjejë njeri që t'i ketë, edhe ta jap autorësinë e vetë, skenarin, regjinë, e aktorët të punojnë pa pare. Shumë vështirë i arritshëm kjo shifër për rrethanat që, në vendet tjera do të ishte shumë i mirë ku ka prodhimtari, ku ka distribucion të mirë, financohet një projekt 50%. Mirëpo, edhe në Shqipëri po e them, në Kroaci pak i konsultova edhe tjetër kund, nuk saktësohet ky numër, matematikisht është, le të bëhet shumëzohet me 0.51 dhe del sa duhet të jep qendra, mirëpo është problem të krijohet një film me këto kushte, po mendoj.

Unë, u përpoqa të jem esencial në atë që e thash, dokumentet janë ata që duan, i kanë, Ministria i kanë të protokolluara, të dorëzuara datat, unë i kam këtu, do të thotë unë ju jap llogari në institucionet ... që jam aty, nuk kam dashur edhe për kundër t'ua kthejë me të njëjtën, do të thotë të komunikoj unë me institucionet ... përmes gazetave me ta, ja shikone edhe tash nuk janë. Kam bërë përpjekje, kjo është puna ime. Ju them asnjë punë nuk mund të bëhet, unë mund të shkruaj

shkresa, rregullat janë shumë të vështira, të blihet një tabak letra. Prej që ekzistoj unë aty i kam marrë 3 tabak letra, një ua kam huazuar Kosva-Filmt, edhe dy fletore edhe njerëzit thonë jo ligji këtu, ligji parasheh të vejnë taksa, të bëhet kjo, të bëhen ato, pa njerëz nuk bëhet. Minimumi i këtyre njerëzve është – këta pesë njerëz, të hartohet një rregullore për projekte edhe Ministria ta nxjerrë statusin e institucionit, do të thotë asnjë hap. Unë ju them këtu, edhe këta nuk mund të bëhet, qendra nuk gjiron filma, qendra i përzgjedhë projektet, unë ju garantoj edhe ju premtoj që do të bëhet një juri reprezentative, pa konflikt interesash, ai që e ka projektin e vet, normalisht nuk duhet të jetë në juri, nuk do të jetë në juri, ata që i përzgjedhë, kushtet i kanë shumë të rënda. Këtu në konkurs i kam cekur se çka duhet të plotësojnë firma e tyre, si vi te autorëve kryesor, fondet, xhirollogaritë, mënyra e xhirimit, i dinë këta edhe këto janë të gjitha. Prandaj, është një presion pozitiv i ashtuquajtur që mund të bëhet edhe me Kryeministrinë edhe me ministrin, edhe të gjendet për këta njerëz që presin një fond, unë nuk e di ministria duhet të ketë fond që, para katër – pesë viteve janë ndarë mjetet për kinematografinë. Janë xhiruar me bashkëprodhim dy – tre filma edhe të gjenden mjetet, do të thotë kjo është, nuk punohet pa njerëz nuk bëhen këto operacione, dhe pa buxhet – shkurt.

Ligji i ka të metat e veta, mirëpo nuk është një ligj i cili nuk jep mundësi për zhvillimin e kinematografisë. Në të ardhmen mund të amendamentohen dy-tri sende ose më shumë, si të shihet e arsyeshme.

KRYETR I KOMISIONIT ENVER HOXHAJ - Ju faleminderit z. Hamiti. Urdhëroni

Unë jam Agim Sopi regjisor,

Vërtetë dua ta falënderoj këtë Komision parlamentar për një reagim urgjent kisha me e quajtur, për një seriozitet ndaj kësaj çështjeje, sepse për fatin tonë të keq në Kosovën e pasluftës po ndodhë një shpërfillje totale madje, madje edhe një nënçmim ndaj inteligjencës në përgjithësi dhe në veçanti ndaj artistëve. Kjo shpërfillje detyrimisht do ta ketë një ditë koston e vet, kjo kosto veç ka filluar të faturohet.

Do ta fillojë këtë diskutim me një prall: Menjëherë pas luftës së Dytë Botërore e kishin pyetur disa revistë Stalinin: Çfarë mendonte për artistët? përgjigja ishte: Do të isha shumë i lumtur sikur mos të ekzistonin fare, dhe të njëjtën natë Nikollai Mihajl Sergejeviq Susllov kishte kërkuar një takim urgjentë me Stalinin dhe pas atij takimi në ditët e ardhshme Stalini kishte njoftuar të gjithë elitën e Rusisë dhe shkrimtarët më në zë nga Boris Pastornavko të Bullgakovi dhe Josip Maldin Shtajmi e të tjerët, dhe kishte krijuar kruzhoqet letrare, ju kishte lënë në dispozicion villen dimërore me të gjitha privilegjet që ata të fillonin dhe ta rikrijonin shpirtin e madh rus. Pavarësisht se ai nga disa më ambematikët kishte

dal sërish me deklarata armiqësore duke i quajtur armiq potencial si tipin e Bullgakovit ose më në zë Pastornakut, prapë suslllovi i tij kishte urdhëruar që veprat e Pastornakut të botohen në miliona ekzemplar dhe detyrimisht kishte urdhëruar KGB-në që të lexohen nëpër konviktet e studentëve dorë në dorë.

Në Rusi kishte filluar një thithje e madhe e kulturës dhe një rigjenerim i pashoq, kurse në perëndim ishte krijuar, si të them një perde mjegulle se kinse në Rusi po tkurret, po shtypet kultura dhe arti. Dhe emrat sipas Tërnakut, kishin depërtuar ta përçonin shpirtin e madh rus në perëndim, dhe perëndimi sërish ishte kthyer nga Rusia. Mos harroni se në kohën e Stalinit ka funksionuar, ka pasur shkëlqimin Balshaj Teatër, është prodhuar Andrej Rublovi, janë prodhuar veprat më të mira të letërsisë ruse.

Për fatin tonë të keq, gjeneral Çeku dhe ministri Haraqija nuk e kanë Suslllovin dhe deklaratat e tyre mund të jenë shumë ndoshta më përçmuese se ajo e Stalinit për artistët që do të ishin më të lumtur sikur ne të mos ekzistonin fare. Unë po ju them, nëse nuk do të ekzistonte identiteti shpirtëror i këtij territori dhe i këtij kombi me siguri se nuk do të ekzistonte asnjëherë as shteti i Kosovës dhe për këtë mos të dyshoj askush.

Po e them, sepse shkelja e Ligjit për kinematografi si dhe përçmimi i të gjitha fushave tjera të artit është bërë me paramendim. Është me paramendim sepse nuk është bërë as përpjekja minimale që të përfilllet ligji. Ne këtë ligj, do me thënë një grup, unë jam ndër shkruesit e këtij ligji, e kemi shty me shumë energji, do me thënë ma shumë me një lloj entuziazëm se sa që ka qenë një kërkesë reale e Ministrisë së kulturës së atëhershme dhe e sinqertë, madje, madje ka pasur tendenca dhe ato tendenca fatkeqësisht kanë ngelur në ligj, që ligji të shfrytëzohet si instrument për interesa krejt të ngushta të klaneve të caktuara ose të personave të caktuar. Dhe këto interesa, të cilat për fat të keq kanë ngelur në këtë ligj, sot po e bëjnë ligjin në njëfarë mënyre, jo vetëm ligjin por dhe qendrën Kinematografike po e hendikepojnë po e bëjnë jofunksionale, jofunksionale, sepse Ligji për Kinematografinë parasheh krijimin e qendrës për kinematografi si një institucion superior, suprem për kinematografinë qysh i kanë shumica e shteteve të Evropës dhe shtet e lindjes po ashtu me një farë mënyre si një lloj mini ministrie për kinematografinë, sepse qysh e kanë bashkëfolësit e mi, Kinematografia gjegjësisht filmi konsiderohet si një art më sublim, më depërtues, më komunikues dhe i cili është në gjendje në mënyrën ma sublime dhe më të fuqishme ta hap një dritare të vogël për komunikim karshi botës.

Prandaj, gjithkund këto shtete ku ekziston kjo praktikë, Qendra për kinematografinë është institucion i pavarur, nuk është instrument i asnjë lloj ministrie. Për fat të keq, ne jemi detyruar që në ligj, unë dhe Liraku dhe kemi luftuar, por nuk ia kemi arritur atëherë, aso kohe, ani mirë edhe ti, patjetër, që do me thënë Qendra për Kinematografi të jetë një institucion i pavarur. Me krijimin

e disa neneve në këtë ligj që qendra shkon përmes Ministrisë, për fat të keq Qendra është shndërruar me një instrument jo funksional ose thjeshtë formal të Ministrisë të Kulturës. Nuk është çështja se Qendra nuk po funksionon për shkak të ligjit, mungesës së buxhetit, e çfarë di unë për çfarë, është diçka shumë e thjeshtë. Qendra është krijuar nga presioni i madh i komunitetit të artistëve, jo me vullnetin e Ministrisë së Kulturës, sepse Ministria e kulturës nuk ka pasur vullnet as dy vjet pas aprovimit të ligjit që ta krijojë qendrën, edhe pse ligjshmërisht ka qenë e obliguar që qendrën ta krijoj brenda 6 muajsh, dhe pas dy viteve kur është krijuar Qendra, Qendra është krijuar thjeshtë formalisht për t'u shantazhuar ende pa u krijuar. Është zgjedhur një drejtor dhe formalisht ne e kemi një qendër e cila siç e tha z. Hamiti i ka 15 € private në konto, kurse Ligji e obligon Ministrinë që ta krijojë automatikisht fondin për Kinematografi dhe organikën e qendrës.

Fondi për Kinematografi krijohet drejtpërsëdrejti nga buxheti i Kosovës. Gjeneral Çeku dhe ministri Shatri kanë deklaruar vitin e kaluar se do të ndahen një milion euro për funksionalizimin e Qendrës dhe se do të jetë një lloj përparësie, filmin në këtë vit pavarësisht. Këto fatkeqësisht kanë qenë vetëm deklarata, kanë qenë publike, i kemi pa të gjithë në televizion, por nuk është lëvizur absolutisht në këtë drejtim. Për fatin tonë të keq, edhe gjatë këtyre katër viteve të disa ka vazhduar të mos përfillet ky ligj janë ndarë para për Kinematografi, por ato para kanë shkuar për projekte fiktive, të cilat nuk janë realizuar asnjë herë dhe askush nuk e din kah kanë përfunduar, kjo është defekti kryesor, është një problem shumë më i madh se sa që shtrohet karshi ligjit.

Mendimi im është ky: që të bëhet një presion pozitiv siç e tha z. Hamiti, mbi Ministrinë e Kulturës që të funksionalizohet Qendra në mënyrën më urgjente, që të krijohet fondi për Kinematografi dhe paratë e dedikuara për filmin sado qofshin ato të hedhën në atë fond dhe të hapet konkursi për projektet e mundshme që do të krijohen sivjet. Ky është hapi i parë, dhe hapi i dytë paralel të nisë një proces i amendamentimit të këtij ligji, amendamente të cilat Qendrën do ta pavarsonin si institucion krejt të pavarur, jashtë politikave, sepse nuk mund të bëhet ART-ja ose Akademia e Shkencave instrument i Ministrisë as të Kulturës e as të Telekomit e ku ta dijë të kujt, por duhet të jenë institucione të pavarura dhe kështu, dhe qendra duhet të jetë institucion i pavarur dhe llogaritë që mund t'i jep qendra, mund t'i jap Parlamentit ose Kryeministrit, dhe qysh e parasheh edhe ligji buxheti, fonde për kinematografi krijohen varësisht drejtpërsëdrejti nga buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe nuk ka nevojë që të kapërcej përmes një ure tjetër ure e cila mund të jetë e prishur për momentin dhe paratë mund të avullohen diku. Kaq. Ju faleminderit!

KRYETR I KOMISIONIT ENVER HOXHAJ – Ju faleminderit shume z.
Sopi.Urdhëroni

Jam FLORENT MEHMETI regjisor. Shumicën çka pata në plan me fol, i përmbledhë z. Sopi, por desha vetëm shkurtimisht, shkurtimisht me fol në tri nivele parimore. I pari është pikërisht ky që është bërë ky gabim i mos pavarësimit të qendrave për menaxhimin e fushës së artit dhe të kulturës dhe në fushat tjera edhe shumë shkelje edhe shumë neglizhenca të mëdha janë bërë, pikërisht prej këtyre mangësive, andaj kisha dashur me apeluar te ju si Komision që e mbulonit këtë fushë, dhe në të ardhmen për ligjet e reja që do t'i keni të kësaj fushe, por edhe ligjet ekzistuese me provuar me i amendamentu dhe me, definitivisht me e provuar me e shfuqizuar, me e bërë politikën jo aq të fuqishme drejtë drejt artit dhe kulturës, po besoj që edhe kinematografia është viktimë e kësaj. Ne po flasim për një ligj, por ai ligj është absolutisht në varësi të ministrit nëse e shohim shkallën e gjithë përzgjedhjeve, dhe mendoj që këtu kjo varësi po krijon shumë telashe. Mendoj që jemi në një pozitë shumë të thjeshtë që nuk donë shumë analiza, është një ligj i cili nuk po zbatohet edhe është shkelë. Pse? Veç t'ju rikujtojë që nuk është i vetmi, ka shumë fusha në artë dhe në kulturë që janë neglizhuar, ka shkelje të mëdha, ka manipulime të mëdha që shpesh shkojnë dhe deri afër veprave kriminale që do të duhej të përgjigjeshin me burgosje, dhe ne si komunitet jemi karshi këtyre aksioneve, asgjë nuk ndodhë vazhdohet jeta ashtu si është më së miri dhe kjo na jep me kuptuar për neglizhencën dhe këtë mospërfillje që po bëhet, më së pari ndaj fushës së artit dhe kulturës në përgjithësi, por mandej edhe ndaj nesh si komunitet, dhe mendoj se ka të bëjë shumë me interesin edhe me vetëdijesimin e nivelit qendror të qeverisjes në Kosovë për këtë fushë.

Prapë po supozoj se ju si Komision parlamentar mund edhe këtu të keni një ndikim që definitivisht tash e tutje mos të shihet me aq neglizhencë ky sektor, por besoj se nuk kam nevojë me mbajtur ligjëratë për rëndësinë dhe fuqinë e këtij sektori, por sot po flasim për Kinematografinë - është definitivisht më i rëndësishmi në këtë fushë, është ai kulminanti që krijon shtigje, krijon komunikim shumë masiv edhe ndërkombëtar edhe për këtë kisha me e bërë një ilustrim të vogël me filmin e Buratit, nëse jeni në dijeni, për ata që nuk e din Burati ka qenë i menduar të jetë personazh nga Kosova. Kjo ka qenë në vitin 1999, në fatkeqësinë tonë të madhe që e kemi pas, kemi pas këtë fat që ju kemi dhimbur autorit të filmit për shkak të situatës edhe ai ka vendosur me e zhvendosur atë në Kazakistan.

Për me e ilustruar fuqinë e kinematografisë, vetëm paramendojeni sot, ne me siguri do të ishim në një truezë duke debatuar për atë çka debaton sot Qeveria e Kazakistanit që ka krijuar një komision të posaçëm parlamentar për përmirësimin e imazhit ndërkombëtar të Kazakistanit në botë, që është krijuar si

pasoj i këtij filmi i cili ka thyer shumë rekorde në Amerikë, do me thënë si pjesë e industrisë në Holivud, është film që po besoj, na të gjithë e kemi pa edhe mundemi me e bë shumë lehët, jo krejt këtu që jemi e më shumë, besoj që gjyma prej nesh si realizim është krejt ide, dhe d.m.th kjo kish me qenë mirë ndoshta me ju transmetuar edhe ministrit edhe, meqenëse po flasim publikisht edhe ato që tha Zeqa, është krijuar një kulturë në Ministrinë e Kulturës me fol përmes shtypit, atëherë edhe në këtë rast po flasim përmes shtypit me Ministrinë dhe po ua japim këto mesazhe. Unë kaq kisha në parim. U thanë shumica që desha t'i them me herët.

KRYETARI I KOMISIONIT ENVER HOXHAJ – Ju faleminderit shumë. E donë dikush fjalën? Urdhëro profesor.

EKREM KRYEZIU , profesor i Fakultetit të Arteve, përndryshe dramaturg dhe regjisor.

Me gjithë ato çka u thanë në këtë mjedis prej kolegëve të mi të nderuar, pajtohem edhe jam i bindur se secili prej tyre për këtë problem e ka prekur vetëm majën e ka fol, e ka hapur si të them edhe vetëm majën e Aisbergut, i cili faktikisht pluskon nën sipërfaqe. E kënaqësia ime e madhe do të ishte sikur në këtë tubim të ishin prezentë edhe njerëz që vendosin për këtë punë. Këtu vetëm jemi ne, ne jemi arra, por nuk është guri këtu. Ajo arrë faktikisht me vlerat tona kulturore po ngelë në duar tona pa pasur mundësi ta thejmë. Ju, praktikisht flet mirë për këtë Komision që na ka ftuar dhe na ka mundësuar të qahemi para jush. Mirëpo, unë nuk do të doja që ne të qahemi. Do të doja që ju të qaheni para nesh, sepse ju jeni fajtorë për çdo mosveprim tonin edhe nuk mund të laheni për, si të them gabimet e akciles Ministri. Ne , krijuesit, nuk janë fajtorë, të vetmit të pafajshëm, të vetmit si të them të virgjër janë krijuesit. Pikërisht pse janë të atillë ata janë të shkelur, ata janë të nëpërkëmbur. Krijuesit nuk dinë të manipulojnë, krijuesit nuk dinë të vrapojnë të gjejnë fonde, krijuesit dinë të krijojnë.

E tha Agim Sopi, një koleg i imi i nderuar i ri, atë çka tha që është ashtu. Nëse e duam Kosovën.ne duhet ta duam kinematografinë. Nuk do doja që të krijojmë filma si Borati. Është e vërtetë se na dimë të bëjmë filma të atillë, por nuk do të doja ta kemi atë temë, për arsye se kemi tema shumë më të nderuara , të cilat ia kemi borxh këtij vendi, se ky vend nuk është Kazakistan. Unë mendoj se ky vend ka shumë njerëz më të mirë se sa që janë ata që janë këqij dhe pikërisht për atë arsye ekziston, pikërisht për atë arsye mbështetet prej botës edhe do të doja, që në këtë aspekt, këtë segment të vlerave tona.

Nuk do të doja të krijojë filma me Kosova viti zero ta quaj ashtu për arsye se ne nuk jemi në vitin zero. Ne e kemi për obligim që ta mbështesim atë mendësi, kështu që ne po flasim para jush nuk e çmojë fare, pse nuk e çmoj fare për arsye

se ju jeni pjesë e jona e ne jemi pjesë e juaja e nuk po dua të qahem në mes veti, por duhet të jetë dikush që e prenë. U përmend këtu gjeneral Çeku, mund të them kryeministri Çeku, e do të doja si kryeministër të veprojë si gjeneral nëse ka mundësi edhe të qeverisë faktikisht me Kosovën e pjesa e kinematografisë është pjesa më e ndritshme, që Kosovën faktikisht mund ta bëjë, t'i plotësojë ato mungesa të ambasadave që do t'i kemi nëpër botë, e do të jetë ambasadori më i mirë. E për këtë arsye, do të doja që këtë tubim të mos e evidentojmë se ka ekzistuar e mos të humbim energji, por të vijnë njerëzit jo vetëm ministri Haraqija, por të jetë edhe z. Shatri, sepse ka mundësi të gjinden mjete në Kosovë që të prodhohet faktikisht arti i nderit tonë, arti i ndriçimit të një së kaluare nëpër të cilën kemi kaluar.

Nuk pranoj, nuk mund ta besoj se nuk kemi mjete materiale që të jepen për film, nuk e pranoj atë për arsye se vjedhjet pasuria mendore e krijuesve Kurrkush nuk paguan për atë. Lulëzojnë qendrat, faktikisht televizionet private, lulëzojnë radiot private, kurrkush nuk paguan, e secili krijues faktikisht ka investuar mjete për ta krijuar një vlerë intelektuale të cilët ata e shfrytëzojnë pa pikë turpi. E këto duhet, këto duhet të rregullohen jo prej palës që është në këtë anë, por prej një pjese, asaj palës, por po i shoh këtu disa krijues, në palën tjetër nuk do të doja që të ndahem – ajo anë edhe kjo anë. Kështu që, praktikisht gjatë tërë kohës hezitova a ta marrë fjalën a jo, a vlen të bisedohet për këtë që jam shumë i bindur. Ju e dini, po ashtu, mirë sa edhe unë, se nuk mendoj se unë më patriot se ju, se jam më i ngritur se ju në këtë lëmi. Të gjithë faktikisht komunikojmë me filmin, e pranojmë se filmi na është bërë pjesë, si të them entitetit tonë të përditshëm, për arsye se ne bombardohemi prej, si të them porosive elektronike, që janë pjesë e filmit, kështu që pa dashur të fajësoj, por duhet të them se të vetmit që janë të ndershëm, është e vërtetë të jenë të virgjër janë krijuesit edhe do të doja se nëse i shkelni krijuesit, nëse i shkelim krijuesin, nëse i shkelim krijuesit ne e kemi shkelur ardhmërinë tonë.

Ju faleminderit

KRYETARI I KOMISIONIT ENVER HOXHAJ – Ju faleminderit profesor, urdhëroni.

FAHRI HYSAJ

Në bazë të përvojës sime në debatet e famshme që kanë ndodhur prej neve artistëve vetë, z. kryetar i Komisionit, me gjithë nënkryetarin dhe gjithë anëtarët, keni urtësinë dhe durimin e juaj dhe përvojën e juaj që të vendosni, të mos na leni që të luftojmë prapë në emër të grupeve të interesave.

Unë betohem në tre fëmijët e mijë nuk flas me grupin e Kosova Filmit dhe me dhëndrin tim, sepse këtu jemi sharë dhe kemi thanë, një institucion i komunistëve

duhet me u shuar, sepse ne nuk jem përjashtim. Kanë lypur dhe sot marrin rrogë Kosova Filmi hala prej buxhetit të Kosovës, një institucion që nuk guxon me ekzistuar. Kjo është sikur me ekzistuar një segment i sigurimit ish- jugosllav, ekziston sepse grupi i artistëve këtu ka votuar atë dualizmin e që u tha atje. Duhet me u nderuar nenet. Këtu kanë votuar njerëzit për me kanë me larë z. Brajsheorin në qef edhe tre, Hasan Zekës drejtor i sepse ne jemi populli më i çuditshëm, kulturën ia kemi dhënë tri qeverive të përkohshmes. Inxhinierit teknik të dytit, ekonomistit, tretit ekonomistit. Gati të garantojë dhe jam ma se i sigurt të betohem edhe të fitoftë PDK-ja, e simpatizoj , s'ka mu zgjedh Lirak Çelaj kurrë ministër i Kulturës, sepse logjika është e jonë kështu, makar ulja e këtij pazari i kësaj qendrës kulturore është faji jonë. Ju lutem zoti Komision, na thirrni urgjentisht që ta amendamentojmë këtë ligj, edhe ky ligj të hyn në zyrën e këshilltarëve të kryeministrit, nuk ka kryeministri me zgjedh shefin e kulturës një diletant jurist. Nuk ka sekretarja me kanë dilitante e kulturës, nuk ka klonizim gjakovarë e një llapjan, 20 llapjanë në punë. Nuk ka te kryeministri te kryetari kesi budallaqe. po nuk ka as te liderët e partive. Apeloj ju jeni z. Nimon Alimusaj, unë jam te LDK-ja ndër të parët aty, apeloj te partia jote mos të na nxinë jetën me dilantizmin e kuadrove. Apeloj z. Enver Hoxhaj që te lideri i juaj partiak të na thirrni t'i amendamentojmë ligjet, sepse prapë kem dilema që i kemi ba vetë para katër vjete. Nuk e fajësoj Komisionin, na ka dëgjuar. Këtu jemi vra, mua mi ka dhënë shteti 200 euro pare për katër dëgjime, m'i ka tha paret kesh. Jemi ku jemi. Vendimi jonë është i krejtëve me u bë të sinqertë. Ne e kemi pruar këtë ligj, e kemi votuar me vota të fshehta. Këtu nuk e kam votuar këtë ligj, me kanë sharë pse për atë nenë, por pse po e lypë ndihmën e Qeverisë, i kam dhënë këtu argumente dhe që po i jap sot, e cila është përpara. I kam thënë për Kosova Filmin që duhet me u eliminuar, sepse u themeluar qendra e re, u eliminuar SUP-i i Jugosllavisë, u eliminuar Kuvendi e ai tjetri, u eliminu, u ba demokracia erdhëm ëndrra jonë e krejt Evropës. Jemi qytetarë evropianë. Kjo është pikë e marrëveshjes të stabilizim- asocimit që e ki z. Jeni specialist i kësaj lëmie, i jep djalit tim mësim.

Për këtë punë, e kemi detyrë ndaj Evropës me hi në Evropë .Këto pika që po i them, e pse na bëjmë kesi farë lojërash? Të lutem edhe një herë, në mbledhjen e ardhshme mos na thirr më me thirr ministrin, e din ti se ministri nuk të dëgjon, nuk ki fuqi, por thirrna ta amandametojmë, ta çojmë në Parlament, të votohet edhe një here në Parlament, sepse rruga ligjore kjo është nuk mund të amendamentohet ligji pa kaluar në Parlament, pa e dëgjuar dëgjimin e parë, pa fol njëqind parlamentarët aty. I dimë krejt këto rregulla, veç naivi flet në hava dhe thotë jo rregull është ligji, por thuaj ministrin të mi qo edhe 500 mijë euro, ai ti qetë 100 mijë. Tani i themi jo thuaj edhe një here 300 mijë, e tani kur shkojmë të konkurrojmë thotë Zeqa, filmi nuk bon se filmi kushton 600 mijë euro, s'mund. Ia jep dy dokumentarëve edhe prapë jemi në zero. U bo viti 2008, jem gazi i Evropës, amoni ju koftë, më mos e bëni punën e televizionit, 5 milion euro i jep Kuvendi, 5 taksapaguesve 10, bënë urgji Agim Zatriqi me 6

vjet, i ka thyer krejt afatet ,jem,jem kush jemi. 10 milion euro i merr zotëria 2500 u ka leju ligji. në debat është ligji ma i mirë. Ka shkuar z. Ismet Salihu në Evropë, në Këshill të Evropës, ka thënë Ligjin më të mirë e keni, nuk e votojmë. Kush? Tri partitë kanë interes, me mbetur Agim Zatriqi apo zonja tjetër, nuk ka faj askush këtu ma. Ka faj Parlamenti i Kosovës me njerëz që jeni brenda që në debat nuk i akuzoni ministrat dhe klanet e caktuara që e kanë kapur shtetin.

Ju lutem mos të bëjmë edhe për këtë ligj. Na thirrni ta rregullojmë dhe hymë në derën e kryeministrit dhe në derën tënde, në derën tënde në derën e kryeministrit shumë ma lehtë, por nuk hymë te tulifarë budalla aty se nuk din çka është ky ligj. A jeni normal thotë, më leni t'i marrë do pare ta bëjë një shpi një veturë, e dreqi i mallkum...po e keni Teatrin e Operës së Baletit.

20 milion, asnjë njeri prej këtij Kuvendi nuk është në Komision për vlerësimin. Prapë e ke shpallë konkursin. A është kompetencë e jote zotëri, kryetar i Komisionit për Kulturë. çka është Teatri i Operës dhe Baletit për ty? Është dy hektarë e gjysmë tokë, një popull prej 8 milionëve, ti nuk je në komision. Pse nuk e ki bo komisionin, mekanizmi me kon, kryeministri me pas mekanizmin. Kryetari duhet me pas mekanizmin, tetë injorantë janë në komision, 20 milionë euro i shpërndanë. Unë e kam paditur shtetin. Fal zotit 3 njerëz të mirë e kanë prishur konkursin me dy vetë të tjerë, kujt nuk i hëngër palla, 20 milionë euro ndërtohet Teatri i Operës, kujt nuk i hanë palla për këtë, më së pari juve. Edhe për këtë pikë amoni të koftë na thirr ta kryejmë këtë punë. Më fal, më fal, dhe një herë më fal.

KRYETARI I KOMISIONIT ENVER HOXHAJ – Ju faleminderit. Do të thotë, nëse ka të tjerë që edhe një herë janë të interesuar të plotësojnë diçka, me shumë dëshirë Okej

Unë jam BURBUQE BERISHA, jam regjisore e filmit. Zoti kryetar, anëtarë të Komisionit ju faleminderit shumë që e keni pasur durimin për me na dëgjuar. Jemi shumë të mllëfosur, të gjithë prej neve për situatën që e kemi, do me thënë se kur takohemi me kolegë tonë të shtetit, të rajonit jemi si lypsa të vegjël në ato festivale. Unë e kam përjetuar shpeshherë d.m.th.atë dhe nuk kisha pasur qef me e përjetuar kërkush tjetër.

Në qoftë se jemi në formim të shtetit edhe në qoftë se secili prej juve keni anëtarë të disa partive politike, që e keni fituar votën tonë, se secili prej neve besojmë që kemi dal në ato zgjedhje të lira. Pjesa e juaj e elektoratit parazgjedhore ka qenë e bombardume me ata filmat e shkurtë në televizione. E dini sa është e rëndësishme edhe sa kemi dhënë që ata filma të shkurtër, reklama të janë të pranishme, do më thënë që të na bindni se ju jeni ata të cilët keni me i mbrojtur interesat tona. Do me thonë e dini shumë saktë sa e

fuqishme është mediumi i filmit. Kjo shkelja që është bërë, unë pajtohem, do me thënë më së pari me Lirakun i cili shumë mirë e elaboroi, e ka këtë pjesën edhe politike edhe artistike shumë të aftë edhe, ndoshta neve tjerëve na mungon ajo pjesa për me i shpjeguar të gjitha këto. Po dua me thënë që, deri sa jemi para statusit edhe deri sa serbët bëjnë filma për Kosovën, i kanë sivjet 5. edhe kudo që është konferencat shkojnë në dhe bëjnë festivale dhe bëjnë kampanja, se sa të pafajshëm kanë qenë, në luftën tonë me neve, ne jemi këtu përballë jush, për me kërkuar të drejtat tona elementare, që të jemi zë i fuqishëm i Kosovës në botë.

Do me thënë kjo është shumë e padrejtë. Unë mendoj që pjesa kryesore është shkelje e të drejtave të njeriut e mandej shkon në të gjitha këto, e është pjesa më e diqshme e kulturës. Të gjithë mendojmë, është punë shumë e thjeshtë, duke ditur se filmi ka një buxhet dhe një kosto shumë të naltë dhe shumëkujt i konvenon që mos të shkojnë punët ashtu qysh duhet.

Do me thënë herën tjetër nuk kishim dashtë me pasur shkelje të procedurave. Herën tjetër, në qoftë se Ministri nuk e ka vullnetin e mirë, atëherë do të kishim kërku që kryeministri ose edhe do të marrim edhe ne masa tjera me siguri, se gjithë prej neve jemi tatimpagues të kësaj Kosove, me ato pak që fitojmë edhe gjithë jemi pjesë e Kosovës edhe do të marrim edhe hapa tjerë. Kështu që kite me qenë shumë e mirë, edhe shumë e rregës që të merret sa më shpejtë një hap i duhur për këtë çështje. Ju faleminderit!

KRYETARI I KOMISIONIT ENVER HOXHAI:

J faleminderit, zoti Hamit

ZEQIR HAMITI:

Unë desha vetëm një ,në qoftë se më lejohet pak në këtë bisedë, në këtë ankim, një reagim të vogël ndaj zotit Hysaj Fahriut. Nuk jam unë këtu ta mbroj “Kosova Filmin”, mirëpo Kosovafilmi për vite të tëra ka funksionua si i vetmi institucion për kinematografinë dhe i tillë nuk mund të krahasohet me një organizatë, një shërbim të fshehtë, filmat të cilët gjithë që janë bë në Kosovë janë bërë përveç dy filmave të fundit, janë bërë me Kosovafilmin. Këtu janë kolegët të cilët kanë punua, do të thotë një krahasim i tillë. Mirëpo me transformimin e krejt kampit ta quajë, socialist, ish- komunist, ndërmarrjet shtetërore për prodhimin e filmit janë trnaferua.

Shteti ose duhet ta mbajnë ne me kapital, nuk ka logjikë të mbajë diçka sepse në rrethanat ekzistuese duke lexuar këtë ligj, Kosova Filmi nuk mund të fitojë projekte sepse asnjë njeri për Kosova Filmin në ndërmarrje e shtetit për prodhimin e filmit, nuk do ti ketë 50% të mjeteve të financojë në atë prodhim. Do të thotë vetvetiu me këtë ligj në një mënyrë është i hendikepuar sepse nuk del, ndërsa prodhuesit individual ose kompanitë e ndryshme do të japin para, Kosova Film

nuk do të ketë. Mirëpo mundësi për transformimin e Kosova Filmit ose për funksionimin e tij, ekziston. Çka do të bëjë, si do të bëhet nuk është e imja, mirëpo desha, është sado euforik e ndoshta në emocione nuk është një krahasim me vend. Kjo është.

Një replikë, mos të keqkuptona

Besoj që ju e keni kuptua që desha me thënë, ajo diçka, në sistemin e institucioneve janë shua, edhe do të shuhet edhe ky pa dhimtë, sepse para dy vitesh kemi debatua kështu. Ta lëmë edhe pak Kosova Filmin, ta lëmë edhe Hysamedin Azemin kryetar të Kuvendit, po ta bëjmë edhe kuvendin e ri me republikën e re. Ky gjysmë, ky britizmi jonë është kështu. Për ata apelova, vendosni vet, mos na leni më me vendos, se kemi pak faj.

KRYETARI ENVER HOXHAI:

Ju faleminderit, urdhëroni dhe nëse edhe dikush tjetër ka të shtojë, masandej sigurisht anëtarët, unë kam misionin do të marrim qëndrim rreth debatit që patëm deri më tash.

xxxx

Veç mora shkas për me servu, po më duket nuk më ka kuptua drejtë profesori i nderuar zoti Ekrem Kryeziu, Buratin e mori si shembull për me ilustrue fuqinë e filmit, edhe shpejgova që Burati është mendue atë që e thotë për Kazakistanin me e thënë për Kosovën. Kjo është e vërtetë edhe do të thotë, kjo nuk thashë që na duhet të prodhojmë filma si të Buratit. Veç këtu dashta nëse edhe dikush tjetër më ka keqkuptua ju faleminderit!

Veç pak

Nëse më falni që po ndërhyjë prapë po kisha dishtë me u spostua debati debati, do të thotë polemika që shkojnë midis nesh, sepse këtu më duket të gjithë jemi për një qëllim, pak a shumë po rrehim në të njëjtin tel, si Nastradini e kemi gjetë atë perdën. Puna është se si ta ndryshojmë problemin. Do të thotë unë veç kisha me e përfundua ndoshta këtë, më falni sidomos për zonjat që janë prezente këtu do të thotë, Boshnjakët tashmë e kanë një shprehje proverbiale për çështjen e filmit mbasi e kanë marrë me filmin e tyre “Niqija zemla”(“ Toka e askujt,”) Oskar in thonë:” Jebesh ti zemlu koja nema Oskar”. Unë po them:” Jebesh ti zemlu koja nema uopshte film”.

KRYETARI ENVER HOXHAI:

Urdhëro

AFRIM SPAHIU:

Zoti kryetar, të nderuar anëtar të Komisionit. Pas një dimri shumë të ashpër dhe të një gjumi shumë të rëndë, në fushën e artit, natyrisht dua të jap informata të tjera, por u bë një zgjim që unë do ta përgëzoja dhe do t' ju uroj që të na hapni një rrugë nëse e keni marr me një seriozitet si në mënyrën se si na keni ftuar. Ju përsëritës dhe ju them me një zemër të hapur që jemi në një hall shumë të madh, një hall të trashëguar, një sëmundje shumë të rëndë, por me shpresë që në frymën demokratike mund të zgjidhet dhe mund të zgjidhet dhe mund të kontribuojmë që të japim një rrugë më të mbarë kinematografisë kosovare.

Nuk dua të shtojë se jemi dëgjuar nga shumë të them kolegë këtu dhe nga ju për problemet që janë, por një dëshirë e kam shumë të madhe. Na mundësoni të gjejmë një rrugë sa më të shpejtë, të krijojmë një kinematografi sadopak të vogël, por me mundësi që të reflektojë dhe të hap rrugë më të shëndosha për një zhvillim më të hovshëm.

Nuk dua të ju marr kohë, e di që shumë folëm dhe bëmë zhurmë, por besoj që do të jetë me efekt, dhe në veshët tuaj do të ndikojë që ju të bëni të them rrugëtim dhe kërkesë që atje ku duhet që edhe në disa e dimë atë mënyrë se si në mënyrë të them kështu më tepër informative, që të hapet kjo rrugë dhe të nismë më e mbarë. Ju faleminderit shumë dhe besoj që në të ardhmen do të kemi prezent edhe anëtarët e Ministrisë që të shprehim ne mendimet tona në mënyrë më të them kështu precize dhe ma dinitoze, Ju falimiderit!

KRYETARI ENVER HOXHAI:

Ju faleminderit njashtu, urdhëro Blerim

BLERIM GJOCI:

Vetëm nëse bën, se po më duket se u ofrua fundi. Kisha me kërkuar, kisha një kërkesë, të fundit, do me thënë si ndoshta konkluzion, gjithë asaj që u tha, në emër të Unionit të Artistave të Filmit. Përveç kërkesave që i thamë më herët për funksionalizimin dhe që të ringjallet dhe të them ashtu rrotë e ndryshkur të lëvizë nga vendi, ne po ashtu si union kërkojmë që të mos harrohet gjithë ajo që ka ndodhë deri më sot. Pra, të mos harrohet përgjegjësia, krimi duhet të hetohet.

Me këto buxhete është manipulua. Ne kërkojmë fuqimisht që të thirrim në përgjegjësi ata që kanë manipulua me këto projekte, të dalin para drejtësisë. ju faleminderit shumë.

KRYETARI ENVER HOXHAI:

Ju faleminderit, gjithashtu, Nëse dikush prej mysafirëve të pranishëm nuk dëshiron të shton edhe diç tjetër, fjalën i japi profesorit Nimon Alimusaj.

NIMON ALIMUSAJ:

Ju përshëndes të gjithëve. Po ndalem si e kemi pritë ne si Komision këtë takim edhe si duket e nxora një konkludim si e keni pritur ju këtë takim. Qëllimi i këtij takimit tonë me ju, këtij dëgjimi publik ka qenë të kërkojmë ndihmë prej jush si mund ta ndihmojmë televizionin, këtë kinematografinë filmin shqiptar, ndërkaq po duket se ju e keni kuptua se si të na sensibilizoni ne e të na shqetësoni për pozitën e rëndë të filmit të Kosovë.

Unë kujtoj se jo vetëm anëtarët e këtij Komisioni, po secili qytetar i arsimuar i Kosovës është i shqetësuar për pozitën e filmit shqiptar në Kosovë. Aq sa është i shqetësuar për filmat që na i sjell televizioni publik, si e tha zoti Hysa dhe televizionet tjera me 18 orë film, degjenerues që po i degjenerojnë jo vetëm rininë po edhe plakat tona, se edhe plakat po mbasin deri në mesnatë para televizionit.

Ne kemi qenë të shqetësuar për këtë, besoj që të gjithë qytetarët e arsimuar që e dinë që është arti dhe cila është fuqia e artit filikë në gjithë shoqërinë, po shqetësimin tonë e kemi smadhua akoma më shumë ju me këto prezantimet tuaja që nuk i kemi marrë me mend se janë të një shkalle kaq të lartë. U hapen shumë dilema, vlen apo nuk vlen ligji, duhet ndryshuar apo nuk duhet ndryshuar, etj. po të gjitha këto të çojnë që nuk po funksionon filmi. Ne si Komision nuk dua ta zgjas shumë, nuk e kemi atë fuqi që disa, doli prej jush që mund ta bëjmë si Komision.

Ne mund të bëjmë dhe do ta bëjmë me siguri amendamentimin e ligjit dhe këtë e kemi kompetencë dhe këtë mund ta bëjmë bash kur të doni .Do të ishte e mira që ju të jepni konkret, neni kaq, kaq, duhet të ndryshohet, të jetë ky, ky edhe ne u garantoj pse ju konsideron si ekspertë që ato amendamente që ju do t'i propozoni do t'i shtyjme.

Ne mund ti detyrojmë sigurisht kryetari ka qenë i interesuar pak para se ta marr fjalën, të bisedoj me mua që, ta thërras, jo vetëm ministrin e kulturës i cili se besoj që do të vijë, po e qon vikend, se për me ardhur në kesi tubime duhet të ketë së paku njohuri për sferën, po si e tha kryetari, mua ma tha kështu, do ta kërkojmë edhe ministrin e buxhetit edhe Kryeministrin etj. dhe këtë do ta provojmë për derisa të kryhet.

U përmend çështja e partive, menjëherë dua të ju them se ky Komision është i përbërë prej gati të gjitha partive dhe asnjëherë për asnjë ligj nuk kemi qenë të ndarë po kemi qenë unikë, pa marrë parasysh a janë të partive opozitare apo partisë në pushtet dhe fakti ajo ekspozë e zotit Hamiti tregoj, unë po e marr ndoshta gabohem se është i Lidhjes Demokratike, po më duket ka qenë ma ai rrepti për Ministrinë e Kulturës sot këtu.

Ju thatë konkretisht që nuk keni muajt me komunikate me Ministrinë e Arsimit, me asnjë kërkesë që ia keni bërë. Edhe në këtë aspekt, përveç amendamentimit ,përveç thirrjes së atyre që duhet se këtu po dihet që paratë është elementi kryesor, ani që paska edhe keqpërdorime në këtë sferë që e tha ai zotëria. Ne mund ti ftojme, por mund të ndikojmë së treti edhe tek disa funksionarë që kanë kompetencë këtu, të partive të ndryshme. Ai e kërkoi publikisht se të kërkojë zoti Nimon Alimusaj prej Lidhjes Demokratike, ministri pikërisht është pikërisht i kësaj partie, me gjithë qejf do ta bënim këtë sa kemi fuqi të ndikojmë.

Megjithatë ne jemi mjaftë të senzibilizuar edhe pa ardhur këtu dhe vërtet është periudhë shumë e pseudovlerave dhe presim të kemi vlera në film. Ju po e shihni. Merreni veç artin e muzikës, që e shkatërroi muzikën shqiptare, shikoni letërsi, ka edhe letrarë këtu, ka pak pare nxjerr librat, i kanë mbulua çarshitë librat duke shitë krejt pseudovlera si e thoshte dikur drejtori i filmit të Kosovës Azem Shkreli. Unë u përshëndes, e më prek ky shqetësim i juaji, ne aq sa kemi mundësi si Komision me siguri se do ta bëjmë punën tonë. Ju faleminderit!

KRYETARI ENVER HOXHAI:

Ju faleminderit shumë profesor Nimani. Profesoresha Sala Ahmetaj

SALA AHMETAJ

Përshëndes të gjithë të pranishmit. Ju kam dëgjuar me shumë vëmendje. Besoni nuk e di kur kam qenë me e tronditur se sot. Më keni lënë pa gojë edhe pa tekst, absolutisht. Nuk dua të bëj demagogji, por të gjithë e dimë se pa identitet shpirtëror të mirëfilltë, nuk mund të ekzistojë kombi as shteti. Fatkeqësisht kështu po ndodhë në Kosovë. Shteti ligjor nënkupton institucionalizimin e lirisë edhe të demokracisë. Por, përveç institucionalizimit në të cilin po thirremi të gjithë ,nënkupton edhe përgjegjësinë. A ka dhënë dikush përgjegjësi, për mos përmbushjen e detyrimeve, për mos përmbushjen e ligjit? Unë i dëgjova të gjithë me vëmendje edhe diskutimet edhe arsyetimet, por a ka kërkuar dikush përgjegjësi nga ata që janë të detyruar, të obliguar ta respektojnë ligjin.

Sa po e shoshim ne jo.

Ne si Komision e kemi edhe për detyrë që t'i monitorojmë ministrinë sa përfilllet ligji jo vetëm ky, po edhe ligjet tjera. Fuqia jonë, si duket as e jona nuk është aq e madhe, por shpresoj se në të ardhmen do të ndërrojnë gjërat edhe me një vetëdijesim dhe ndërgjegjësim të përgjithshëm të gjithëve, sepse kjo është për të mirën e të gjithëve. Unë ju falënderoj edhe po ju them sinqerisht nuk di kur jam ndier më keq se sot.

KRYETARI ENVER HOXHAI:

Genc Gorani

GENC GORANI:

Ju faleminderit zoti kryetar, përshëndetje për të gjithë zonja dhe zotëri, Nuk desha të kyçem fillimisht, mirëpo, është një segment shumë i rëndësishëm i funksionimit të përgjegjësisë të atyre të cilët e kanë marrë vetën në një moment dhe e kanë marrë udhëheqjen e një dikasteri, veçanërisht në këtë dikaster kaq të rëndësishëm, siç është ky, tha është Ministria e Kulturës.

Është fakt po ashtu që ky Komision në këto vitet e kaluara ka funksionua në një bazë të koncenzusit, në mënyrë konsensuale. Mirëpo është fakt po ashtu se kurrë nuk kemi pasur çështje të cilat kanë sfidua këtë konsensus. Krejt thjesht për të shkua deri në fund të kësaj logjike, duhet përmend se në asnjë moment në këtë komision ne nuk i kemi shqyrtua përgjegjësinë e asnjë ministri apo ndonjë zyrtari tjetër për lëshime në ligje. Ndërkaq, lëshime në ligje kemi konstatuar faktikisht gjithë kohën e funksionimit tonë. Është një defekt jashtëzakonisht destruktiv në shoqërinë tonë që ne, që partitë tona, tash nuk po dua me u nda aspak në atë aspekt, funksionojnë në atë mënyrë që të emëruarit në poste të larta, pas emërimit bëhen të paprekshëm.

Se çka është ajo që funksionon në atë, me siguri shumë kush e dinë më mirë se unë. Me siguri edhe ju i dini se çka ndodhë aty, mirëpo aty është ndoshta një prej arsyeve dhe burimeve të këtij problemi.

Tash jemi në një fazë, në një periudhë kur e gjithë kjo për fat të keq, është edhe vështirë të, ky lëmsh është vështirë të çlirohet për shkak të proceseve të ndryshme. Natyrisht që janë të rëndësishme, mirëpo duhet ndoshta me këtë rast ta bëjmë një kapërcim të atillë, prandaj institucioneve tona, që do të vërtetonte se ne do të mund t'i tejkalonim do çështje edhe brenda këtij procesi kaq delikat dhe të rëndësishëm, pa e vu në pyetje këtë proces, pa i vu në pyetje, do me thënë funksionimin e tërësishëm. Është jashtëzakonisht e pakapshme të mendohet se dikush i cili kurrë praktikisht nuk vjen as në seanca parlamentare dhe nuk përgjigjet në asnjë ftesë, qoftë Komisionit, qoftë kudo qoftë tjetër, është në gjendje të kalojë pa kurrfarë gërvishtje. Po e mbaroj me kaq. Ju faleminderit!

KRYETARI ENVER HOXHAJ:

Ju faleminderit, profesoresha Gjylshene Berisha

GJYLSHENE BERISHA:

Ju faleminderit kryetar. Nuk pata ndërmend ta marr fjalën, por meqë ju dëgjova me vëmendje të gjithëve dhe e pashë që ju e ndatë një shqetësim shumë të madh që na takon edhe ne të merremi me atë shqetësimin tuaj. Mendoj që pak ndoshta kishte zëra më tepër se që shprehnin emocionet, mendoj dëgjimi publik, organizohet për të dëgjuar dhe për të parë për të mirësuar atë që nuk bën dhe ne si

Komision i Arsimit dhe i Kulturës, vërtet- tha zotëri Genci që nuk kemi pasur rast në të cilët kemi qenë të sfiduar. Kemi qenë edhe të sfiduar, po megjithatë e kemi tejkaluar, sepse Komisioni punon në mënyrë unike për një interes më të madh.

Ashtu si dhe nuk na ka ndodhur asnjë herë të votojmë, mirëpo, të them ky shqetësim për filmin, për pozitën e filmit vërtet duhet të jetë shqetësim i të gjithëve, sepse ne kemi filma të cilët janë vlerësuar dhe janë çmuar jashtë më tepër se sa që çmohen këtu. Kemi filma të cilët kanë marrë mirënjohje, kanë marrë po them, janë shpërblyer në botë dhe ne nuk ia kemi kushtuar së paku një javë ditë rresht të shkruajmë për atë film, sepse është paraqitur Kosova, sepse vërtet kanë qenë një lloj ambasadori.

Unë do të doja që megjithatë t'i marrë këto emocione si një shqetësim për ne, për grupin, apo për Komisionin, që të merremi seriozisht me këtë punë, që të marrim vërtetje të cilat ju do të na i dorëzoni sigurisht edhe me shkrim, të bashkëpunojmë dhe të shikojmë të ndryshojmë atë që mund të ndryshohet. Doja ta them në fillim, e dini çka, unë jam e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Këtu jemi të gjithë këtu deputetë, do ta pyes ministrin dhe do të "vendosim". Për të mos keqkuptuar, do ta bëjmë vërtet ashtu si duhet, nuk kam dëshirë premtimet, por mendoj që duhet, Sot ne vetëm iu kemi dëgjuar dhe si Komision do të takohemi vetë do të bisedojmë dhe do të vendosim bashkërisht përsëri, pa u sfiduar, çka është në interes të kulturës.

Ju jeni në përgjithësi, të gjithë për filmin. E kemi drejtorin, unë desha ti them drejtor i kujt je? Mbas të gjithë atyre të dhënave që i dha, edhe më vjen shumë keq që nuk është funksionalizuar ajo drejtori. Probleme ne kemi mjaft, në të gjitha segmentet, ju e dini që qofshin edhe të teatrit, edhe ata i kërkojnë të drejtat e veta, mendoj kërkojnë jo të drejtat, po që të funksionalizojnë ashtu si duhet. E kemi operën, baletin, vërtet në qoftë se ne e lëmë anën shpirtërore anash në të cilën bënë pjesë çdo gjë, atëherë e kotë është gjithë ajo politikë që mund të bëhet aty, që mos e bëjmë ose mos e zgjasim më tepër këtë debat, unë do ta marr si një presion pozitiv tuajin Komisionit për të punuar, për ta amendamentuar këtë ligj, për ta përmirësuar, sepse ligjet nuk janë bibla apo kurane, ndryshojnë dhe mund ta ndryshojmë. Ju faleminderit!

KRYETARI ENVER HOXHAI:

Ju faleminderit profesoreshë, zoti Çela.

LIRAK ÇELAJ

Ju faleminderit zoti kryesues, mendova që u krye ky debat, megjithatë bisedat fundit vetëm çka po nxisin debat pak më shumë, se sa në të vërtetë duhej të mbyllej.

Për mua është e papranueshme ajo që na do të bëjmë fjalë, se ose nuk kemi, pranimi vetë në komisione, të themi edhe nuk kemi shumë forcë të bëjmë, atëherë më mirë lenë këtë punë krejt, pse na keni thirr. Është e kotë, pse po na thirr, pse po na maltretoni? Unë e di forcën që e ka një Komision Parlamentar. Në qoftë se Kuvendi, në qoftë se Komisioni çon sugjerime në Kuvend, 99% të rasteve ato sugjerime janë aprovu.

Kërkesa për zbatim të ligjit nuk është, e thamë kështu me fjalë shumë të thjeshta, kërkojmë të zbatohet ligji, kaq. Parlamenti ka këtë forcë, nëse nuk e keni këtë forcë, lereni këtë punë. Unë kam qenë kur është zbatua, në atë kohë kamë qenë deputet edhe e shoh shumica prej juve jeni edhe prej mandatit të parë me përjashtim një a dy. Amendamentet që po flasim sot i kam propozuar unë të ndryshohen qysh atëherë, veç pse kanë ardhë prej meje i keni votua kundër. Kjo është, janë edhe transkriptet, janë edhe krejt ato, Mos na dilni këtu që nuk kemi forcë, do ta thërrasim ministrin, jo ne do ta marrim në mënyrë shumë të sinqertë, në qoftë se doni e di që mundeni. Nuk doni me e bë këtë punë.

Këto fjalë i kemi thënë shumica prej nesh, kemi qenë edhe në dëgjimin e mëparshëm. Me amendamente, me krejt këto vërejtje i kemi thënë hala pa u aprovua ligji. Do me thënë ne i kemi pa për shkak të përvojës që kemi ndoshta në këtë fushë, i kemi parë vendet ku çalojnë këto. Ky ligj nuk është zbatua, janë injorua pikërisht prej këtij komisioni. Nuk janë dërguar në amendamentim atje, prandaj mos na maltretoni, në qoftë se nuk keni forcë, ju lutem mos na ftoni më.

Gjithashtu edhe ato qëndrimet unë pajtona që asnjë faj nuk e ka zoti Zeqë Hamiti, do të thotë nuk ka kurrfarë force, për zbatimin e këtij ligji nuk e ka në dorë e ka ministri.. Megjithatë nuk e pranoj atë që thotë nuk duhet me gazeta. Transparenca nuk është me fol ndryshe. Në qoftë se nuk dëgjon ministri duhet gjet një formë që ta dimë ne që ju po përpiqeni, unë e di personalisht, e di prej rrugëve tjera, po opinionin duhet ta di që ju po përpiqeni. Meqë ata nuk funksionojnë ndryshe, nuk takohen, nuk dalin në debate, nuk vijnë në salla të leximit nuk na mbetet formë tjetër, nëse na dom me e ruajt burrinë, mos me i fol mbash shpine dhe mos me fol ashtu, na nuk duhet të flasim hiq. Po ju kisha lutë mos na bëni lojëra me thënë nuk kemi forcë, do të bëjmë, do të përpiqemi, se në qoftë se doni sinqerisht, unë e di që mundeni. Në qoftë se Komisioni donë sinqerisht unë e di forcën e Komisionit, e di forcën e Parlamentit. Asnjë ministër nuk është marrë në pyetje me thënë pse nuk po zbatohet ligji ose të shkarkohet. Aty çdo ditë kjo temë është e fundit që ka ardhur në Komision, çdo ditë ka qenë prezent në gazeta ku keni muajt me u informua. Pse nuk keni bë Komision hetues me shkua me i këqyr a po zbatohet, më herët, pse duhet UAFK-ja me shkrua shkresë, kur këto gjëra kanë qenë shumë publike, me këqyr a kemi film, nuk kemi, çka është kjo punë. E nuk është veç ky ligj, jo asnjë ligj nuk e di duke fillua prej bibliotekave. Më thoni a zbatohet ligji i

bibliotekave?. Aspak hiq, ato jo se nuk kemi objekt për Bibliotekë Kombëtare, të Arsimit ato janë krejt kot.

A zbatohet Ligji për teatrin? Asnjë nen. A zbatohet Ligji për mbrojtjen e monumenteve të cilat asnjë, gjemani një ligj në fushë të kulturës që zbatohet që juve të ju ketë hutua dhe nuk ju ka rënë në sy pahiri, unë e pranoj. Asnjë ligj, asnjë nen nuk është pranua. Më falni.

KRYETARI ENVER HOXHAI:

Të faleminderit, Lirak edhe për këtë shtyrjen e fundit, nuk ma merr mendja që na si Komision ju kemi thirr me bë lojë. Pra këtu nuk do të duhej ta kem këtë fjali të fundit, si ta kemi përmbyllës të këtij Komisioni. Mendoj që në fushat e caktuara kemi krijuar komision, por në fund të fundit, na si deputetë u japim llogari juve një herë në vit, atë ditë kur të dalim në votime, atë ditë mund të mendoni se çfarë pune kemi bë dhe përveç fushës së kulturës e kemi fushën e arsimit.

Javën e ardhshme në këtë sallë, kohën e njëjtë do ta kemi Sindikatën e Arsimit, kështu që ju nuk jeni të vetëm, që kanë shqetësime të natyrave të ndryshme sa i përket mos implementimit të ligjit ose shqetësimeve çka i kanë, mirëpo përshtypja prej që u krijuar në këtë debat i cili ma merr mendja që neve definitivisht si Komision na ka qartësua, mund të jetë përshtypja prej cilës çdo konsumator mund të del nëse e shef ndonjë filëm tllirer.

Ne do të dalim me përshtypjen nga filmi triler prej këtij dëgjimi publikë. Me qëllim që këtë përshtypje ta shndërrojmë në një përshtypje tjetër, unë u premtoj që me datën 2. ose 3 maj ose javën e fundit të prillit, do ta ftojme Zyrën e kryeministrit, jo kryeministrin, që të jem më i sinqertë me juve, do ta ftojme Ministrin e Kulturës dhe departamentin dhe drejtorin për kulturë, do ta ftojme edhe ministrin e financave për me pa çështjen e financimit me qëllim të implementimit të këtij ligji, dhe në bazë të asaj se si edhe zoti Goci, Çelaj, profesor Kryeziu, zonja Berisha, profesor Sopi, të gjithë ju të pranishëm sidomos zoti Hamiti që ke jashtëzakonisht direkt dhe konkret për problemet të cilat i ka qendra, të cilën ai e drejton, e cila është më tepër institucion virtual, simbolik se sa diç konkret, a ne si Komision po e shohim të udhës që në fillim ta kemi një takim a përsëri në funksionet e dëgjimit publik rreth asaj që të fillohet implementimi i ligjit, jetësimi i ligjit.

Nëse gjatë rrugës shihet nevoja e amendamentimit të ligjit definitivisht do të jem në dispozicionin e juaj. Do të thotë, javën e fundit të prillit, varet kur e kemi kalendarin në dispozicion për shkak të seancave, ose javën e parë të majit, në këtë përbërje, plus në frymën e asaj që e tha profesori Ekrem ta kemi edhe atë pjesën vendimmarrëse, do ta ftojme zyrën e Kryeministrit, ministrin e Financave, edhe

ministrin e Kulturës, me qëllim që vërtetë ta shtyjmë këtë qasje, me qëllim që ta shtyjmë këtë kërkesë.

Unë e falënderoj Unionin e Artistëve, ju falënderoj për gjuhën shumë direkte, për melmesat e forta, të përdorura në gjuhën direkte dhe besoj që do t' ju paraqitemi përsëri dhe me gjithat ju falënderoj edhe për frymën kritike karshi punës së Komisionit. Neve na përmirëson që, neve na ndihmon që thjeshtë të jemi të përmirësueshëm.

Ju faleminderit edhe prej juve.